Banka e Shqipërisë

RAPORTI TREMUJOR I POLITIKËS MONETARE

2018/IV

RAPORTI U MIRATUA ME VENDIM TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS NR. 70, DATË 24.12.2018.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 270 kopje
Shtypur nga Adel Co *sh.p.k.*

P Ë R M B A J T J A

PARATHËNIE *7*

1. FJALA E GUVERNATORIT *8*

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË *11*

3. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË *15*
3.1. Ekonomia botërore *15*
3.2. Çmimet e mallrave kryesore në tregjet botërore *19*
3.3. Tregjet financiare *20*

4. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE *22*
4.1. Zhvillimet në tregjet financiare *22*
4.2. Normat e interesit të depozitave e të kredive dhe kushtet e financimit *28*
4.3. Kreditimi i sektorit privat *31*
4.4. Ecuria e depozitave dhe e parasë në ekonomi *33*

5. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE *35*
5.1. Ecuria e inflacionit *35*
5.2. Produkti i brendshëm bruto dhe ecuria e kërkesës agregate *37*
5.3. Gjendja ciklike e ekonomisë dhe presionet inflacioniste *51*

SHTOJCA STATISTIKORE *57*

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë informuese 1: Efekti i ndërhyrjeve në tregun valutor 25
Hapësirë informuese 2: Emetimi i titullit referencë 5-vjeçar 28
Hapësirë informuese 3: Zhvillimet në Bilancin e Pagesave në tremujorin e tretë të vitit 2018 50

PËRMBAJTJA E TABELAVE

3. Ambienti i jashtëm i ekonomisë
Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë 16
Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje 19

5. Inflacioni dhe rritja ekonomike
Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor 37
Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave 50

PËRMBAJTJA E GRAFIKËVE

2. Stabiliteti i çmimeve dhe politika monetare e Bankës së Shqipërisë
Grafik 1. Inflacioni, pritjet inflacioniste dhe objektivi 12
Grafik 2. Norma bazë e interesit dhe ecuria ditore e kursit të këmbimit eur/lek 13
Grafik 3. Përcjellja e stimulit monetar në tregjet financiare 13

3. Ambienti i jashtëm i ekonomisë 15
Grafik 4. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe prodhimi industrial i vendeve kryesore; inflacioni i vendeve kryesore 16
Grafik 5. Eurozonë: indeksi i përbërë i prodhimit dhe PBB-ja tremujore, ecuria e treguesve të vrojtimit të besimit dhe treguesi i ndjesisë ekonomike dhe PBB-ja vjetore 17
Grafik 6. Ecuria e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe vendas 20
Grafik 7. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore 20
Grafik 8. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare 21

4. Tregjet financiare dhe zhvillimet monetare 22
Grafik 9. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar 23
Grafik 10. Zhvillimet në tregun valutor 24
Grafik 11. Kursi ditor euro/lekë 25
Grafik 12. Ecuria e diferencës së çmimit të kursit euro/lekë kuotuar nga bankat tregtare 25
Grafik 13. Pozicioni i hapur valutor i sistemit bankar (në milionë euro – shmangie nga trendi dhe sezonaliteti) 26
Grafik 14. Luhatshmëria ditore e kursit euro/lekë 26
Grafik 15. Yield-et në tregun primar 27
Grafik 16. Ecuria e yield-it dhe volumet e kuotuara ne tregun sekondar të obligacionit 5-vjeçar referencë 28
Grafik 17. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore 29
Grafik 18. Kushtet e kreditimit joçmim për biznese dhe individë, balancë neto përgjigjesh 30
Grafik 19. Normat e interesit për depozitat e reja në lekë edhe euro 30
Grafik 20. Kredia për sektorin privat sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë 31
Grafik 21. Kredia sipas qëllimit të përdorimit 32
Grafik 22. Ecuria e disa treguesve monetarë 33
Grafik 23. Ecuria e depozitave në sistemin bankar 34

5. Inflacioni dhe rritja ekonomike
Grafik 24. Inflacioni vjetor dhe objektivi; inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE 35
Grafik 25. Kontributet e grupeve ushqimore dhe joushqimore te norma e inflacionit, në pikë përqindje 36
Grafik 26. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit 38
Grafik 27. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në "Industri, energji dhe ujë" dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në industri 39
Grafik 28. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e ndërtimit 40
Grafik 29. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve 41
Grafik 30. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme 42
Grafik 31. Ecuria e konsumit privat dhe e indeksit të besimit konsumator 43
Grafik 32. Tregues të tërthortë sasiorë dhe cilësorë për ecurinë e konsumit privat 44
Grafik 33. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore 44
Grafik 34. Tregues afatshkurtër të investimeve 45
Grafik 35. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar 46
Grafik 36. Ecuria e shpenzimeve sipas kontributeve të kategorive kryesore dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë 2013 1M – 2018 10M 46
Grafik 37. Ecuria e të ardhurave sipas kontributeve të kategorive kryesore dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë tatimorë 2013 1M – 2018 10M 47
Grafik 38. Instrumentet e financimit të deficitit, në mld lekë, 2013 1M – 2018 10M 47
Grafik 39. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate 48
Grafik 40. Orientimi i eksporteve dhe importeve sipas kategorive 48
Grafik 41. Ecuria vjetore e çmimit të naftës (Dated-Brent), e eksportit të naftës vendase, e indeksit të çmimit të metaleve dhe e eksportit të metaleve vendase 49

Grafik 42. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë *51*
Grafik 43. Tregues të pagës mesatare në ekonomi dhe ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit *53*
Grafik 44. Prirjet afatgjata të inflacionit dhe prirjet afatshkurtra *53*
Grafik 45. TPHI-ja dhe kontributet e përbërësve të tij; kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor *54*
Grafik 46. Pritjet inflacioniste, ndryshime vjetore në përqindje *55*

PARATHËNIE

Objektivi kryesor i politikës monetare në Shqipëri është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, e përkufizuar në terma sasiorë si ruajtja e inflacionit rreth nivelit 3%.

Nëpërmjet përmbushjes së këtij objektivi, politika monetare nxit rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit, promovon stabilitetin financiar dhe mbështet mirëqenien e qytetarëve.

Politika jonë monetare është gjithnjë e orientuar nga e ardhmja.

Në përputhje me parimet e përcaktuara në Dokumentin e Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë zbaton një politikë monetare konsistente, të balancuar, të kujdesshme dhe transparente.

Analiza ekonomike dhe monetare në këtë raport mbështetet mbi të dhënat statistikore dhe cilësore të disponuara deri në datën 17 dhjetor 2018.

1. FJALA E GUVERNATORIT

Aktiviteti ekonomik në vend ka ardhur në rritje gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018, megjithëse informacioni i disponuar, mbi të cilin mbështetet ky vlerësim, mbetet i pjesshëm dhe i tërthortë. Rritja ekonomike është pasqyruar në shfrytëzimin më të mirë të kapaciteteve prodhuese, sikundër tregon rritja e punësimit, reduktimi i normës së papunësisë, si dhe forcimi i presioneve të brendshme inflacioniste. Kjo ecuri ka qenë përgjithësisht në përputhje me pritjet tona të mëparshme dhe nuk sjell ndryshime të rëndësishme në parashikimet tona për të ardhmen. Ndër të tjera, ajo evidenton ndikimin pozitiv që ka pasur politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë, dhe sugjeron se qëndrimi aktual i kësaj politike mbetet i përshtatshëm, si për të siguruar një rritje ekonomike në linjë me potencialin prodhues të vendit, ashtu edhe për të garantuar kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2020.

Në këndvështrimin sektorial, zgjerimi i aktivitetit ekonomik duket se pasqyron kryesisht rritjen e prodhimit në industri e shërbime. Megjithatë, të dhënat e disponuara tregojnë se ritmi i rritjes së prodhimit të energjisë elektrike ka ardhur në ngadalësim gjatë tremujorit të tretë, duke sugjeruar për një ngadalësim të lehtë të rritjes ekonomike në gjysmën e dytë të vitit.

Në këndvështrimin e kërkesës agregate, rritja ekonomike duket se ka vijuar të mbështetet nga zgjerimi i konsumit dhe i investimeve private, si dhe nga rritja e eksporteve shqiptare. Nga ana tjetër, kahu konsolidues i politikës fiskale, gjatë tremujorit të tretë dhe pjesës më të madhe të tremujorit të katërt, ka qenë më i fortë se ai i parashikuar, duke sjellë një kontribut më të ulët se parashikimi i shpenzimeve publike në rritjen ekonomike.

Në balancë, konteksti i përgjithshëm i zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend mbetet pozitiv.

Ekonomia shqiptare vijon të përfitojë nga ecuria pozitive e partnerit tonë kryesor tregtar, Eurozonës, nga bilancet financiare në përmirësim të familjeve dhe bizneseve, si dhe nga konsolidimi fiskal, i cili ka reduktuar primet e rrezikut në tregjet e brendshme financiare.

Paralelisht me këta faktorë, zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka vijuar të mbështetet nga politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë. Kjo politikë është transmetuar nëpërmjet nivelit të ulët të normës bazë të interesit, injektimit të vazhdueshëm të likuiditetit në tregun e brendshëm financiar, orientimit të tregut mbi kahun e politikës monetare në të ardhmen, si dhe ndërhyrjeve selektive në tregun valutor gjatë periudhës së verës.

Stimuli ynë monetar ka krijuar një ambient financiar likuid dhe me norma të ulëta interesi, si dhe ka zbutur efektin e presioneve forcuese mbi kursin e këmbimit. Normat e ulëta të interesit kanë mbështetur zgjerimin e kreditimit: e pastruar nga efekti i kursit dhe nxjerrja e kredive jashtë bilancit, kredia për sektorin privat u rrit me 4.9% dhe 4.5%, përkatësisht gjatë tremujorit të tretë dhe dy muajve të parë të tremujorit të katërt. Gjithashtu, normat e ulëta të interesit kanë ndihmuar ristrukturimin e kredive, duke lehtësuar kostot e shërbimit të borxhit dhe duke përmirësuar stabilitetin e sistemit financiar. Raporti i kredive me probleme zbriti në nivelin 12.7% në muajin nëntor, duke ilustruar përmirësimin e vazhdueshëm të shëndetit të sektorit bankar. Së fundi, ndërhyrja e përkohshme në tregjet valutore ka reduktuar zhbalancimet e ofertës dhe kërkesës për valutë, duke qetësuar funksionimin e tregut valutor dhe duke reduktuar shmangiet e kursit nga nivelet e sugjeruara nga faktorët fondamentalë.

Rritja e kreditimit, lehtësimi i barrës financiare të kredimarrësve dhe reduktimi i luhatjeve të kursit të këmbimit, kanë inkurajuar konsumin, investimet, rritjen ekonomike dhe rritjen e punësimit, duke krijuar premisa për kthimin e inflacionit në objektiv, në horizontin kohor afatmesëm.

Inflacioni shënoi vlerën 1.8% në muajin nëntor, duke u reduktuar kundrejt nivelit të regjistruar në tremujorin e tretë dhe në muajin tetor. Në përputhje dhe me pritjet tona të mëparshme, ky reduktim pasqyron efektin rënës që sjell forcimi i kursit të këmbimit mbi inflacionin e importuar. Analizat tona sugjerojnë se ky efekt pritet të jetë kalimtar dhe nuk do të cënojë përmbushjen e objektivit të inflacionit në afatin e mesëm.

Përditësimi i parashikimeve sipas skenarit bazë konfirmoi pritjet tona të mëparshme mbi kthimin e ekonomisë në ekuilibër, në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm, dhe kthimin e inflacionit në objektiv, në vitin 2020. Kjo ecuri pritet të mbështetet nga ecuria pozitive e Eurozonës dhe partnerëve tanë të tjerë tregtarë e financiarë, nga ambienti stimulues monetar dhe financiar në vend, si dhe nga qetësimi i presioneve forcuese mbi kursin e këmbimit.

Paralelisht, Banka e Shqipërisë vlerëson se balanca e rreziqeve vijon të mbetet e zhvendosur në kahun e poshtëm. Këto rreziqe lidhen si me goditje të mundshme nga ambienti i huaj, ashtu dhe me shpejtësinë e përmirësimit të klimës së biznesit dhe të kreditimit në vend.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Banka e Shqipërisë vlerëson se politika monetare lehtësuese mbetet e përshtatshme. Ruajtja e kahut dhe intensitetit aktual të stimulit monetar nxit rritjen e kërkesës agregate, duke ndihmuar rritjen e punësimit, të pagave, dhe të presioneve të brendshme inflacioniste.

Në përputhje me parashikimet e skenarit bazë, si dhe bazuar në informacionin e disponuar, rritja e normës bazë të interesit nuk do të fillojë përpara tremujorit të dytë të vitit 2019.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të monitorojë ecurinë e kursit të këmbimit dhe mbetet e gatshme të përdorë instrumentet që disponon, për të shmangur forcimin e kursit të këmbimit në nivele që rrezikojnë përmbushjen e objektivit të inflacionit.

2. STABILITETI I ÇMIMEVE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Zhvillimet ekonomike e financiare në vend janë pozitive, sikurse ilustrohet nga trendi i përshpejtimit të ritmit të rritjes ekonomike, nga baza e gjerë e faktorëve mbështetës të rritjes ekonomike dhe nga përmirësimi i treguesve të tregut të punës. Shfrytëzimi më i plotë i kapaciteteve prodhuese ka sjellë forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Nga ana tjetër, presionet e jashtme inflacioniste vijojnë të jenë të ulëta, si pasojë e mbiçmimit të kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros.

Parashikimet makroekonomike tregojnë se zgjerimi i vazhduar i kërkesës agregate do të rritë shfrytëzimin e kapaciteteve prodhuese të ekonomisë, duke shtuar presionet e brendshme inflacioniste. Inflacioni parashikohet të rritet gradualisht, duke konverguar në objektivin tonë prej 3%, brenda vitit 2020. Politika monetare duhet të ruajë kahun akomodues në afatin e mesëm, por intensiteti i stimulit monetar pritet të vijë në reduktim, në përputhje me perspektivën rritëse të inflacionit. Balanca e rreziqeve vijon të jetë e zhvendosur në kahun e poshtëm në afatin e mesëm.

Informacioni i ri ekonomik e financiar konfirmon trendin pozitiv të ekonomisë shqiptare. Aktiviteti ekonomik ka ardhur në përmirësim, i ndikuar nga kushtet e mira të financimit, nga rritja e investimeve të huaja direkte dhe nga zhvillimet pozitive në ambientin e jashtëm. Përmirësimi ciklik i ekonomisë ka sjellë rritjen e shkallës së pjesëmarrjes në forcën e punës, rritjen e punësimit dhe rënien e shkallës së papunësisë. Në reflektim të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, tregjet financiare kanë qenë të qeta, likuide dhe me norma të ulëta interesi, duke siguruar kushte të përshtatshme financimi për bizneset e familjet shqiptare. Në përgjigje të këtyre zhvillimeve, presionet e brendshme inflacioniste kanë ardhur në rritje.

Inflacioni vjetor mesatar rezultoi 2.2% në tremujorin e tretë dhe 1.8% në muajt tetor e nëntor. Rritja e inflacionit në tremujorin e tretë u ndikua nga rritja e çmimeve të shërbimeve dhe transmetimi i rritjes së çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare. Në vijim, ishte rritja e ngadaltë e çmimeve të produkteve bujqësore, ajo që përcaktoi ngadalësimin e inflacionit.

Në këndvështrimin makroekonomik, ecuria e inflacionit ka gjetur një mbështetje më të mirë nga presionet e brendshme inflacioniste, ndërkohë që presionet e jashtme vijojnë të jenë të ulëta. Inflacioni bazë dhe ai i brendshëm kanë shtuar kontributin në formimin e inflacionit total. Forcimi i presioneve të brendshme inflacioniste pasqyron përmirësimin e aktivitetit ekonomik, shfrytëzimin më të plotë të kapaciteteve prodhuese, si dhe ankorimin më të mirë të pritjeve inflacioniste.

Grafik 1. Inflacioni, pritjet inflacioniste dhe objektivi



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 4.3% në terma vjetorë në tremujorin e dytë të vitit, nga 4.5% në tremujorin e parë. Në këndvështrimin sektorial, zgjerimi i aktivitetit ekonomik u mbështet kryesisht nga sektori i shërbimeve dhe ai i industrisë, ndërkohë që sektori i ndërtimit shënoi rënie. Prodhimi i energjisë elektrike vijoi të japë një kontribut të rëndësishëm prej 1.8 pikësh përqindjeje në rritjen e ekonomisë. Në këndvështrimin e kërkesës agregate, rritja ekonomike u mbështet nga kërkesa e brendshme, kryesisht në përgjigje të përmirësimit të konsumit familjar, ndërkohë që investimet u ngadalësuan. Shkëmbimet tregtare me jashtë mbështetën rritjen e ekonomisë në drejtim të rritjes si të eksporteve në mallra ashtu dhe të aktivitetit turistik. Të dhënat për rritjen ekonomike të tremujorit të tretë dhe të katërt janë të pjesshme. Ato sugjerojnë ngadalësim të ritmit të rritjes ekonomike, ndërsa mbështetësit kryesorë të saj pritet të jenë konsumi privat dhe investimet.

Rritja e kërkesës agregate është shoqëruar me përdorimin më të plotë të kapaciteteve prodhuese, të ilustruar në përmirësimin e treguesve të tregut të punës. Norma e papunësisë ra në 12.2% në tremujorin e tretë të vitit. Me gjithë përmirësimin e pandërprerë të treguesve të tregut të punës, rritja e pagave vijon e ngadaltë. Inflacioni bazë ka shfaqur prirje rritëse, por ai mbetet nën mesataren e vet historike, duke dështuar për një ekonomi që operon ende poshtë potencialit. Pritjet inflacioniste afatmesme të agjentëve financiarë kanë ardhur në rritje dhe aktualisht qëndrojnë në nivelin 2.6%.

Presionet e jashtme inflacioniste vijojnë të japin një kontribut të ulët në inflacion. Rritja e inflacionit në vendet partnere në tremujorin e tretë ka ardhur kryesisht nga çmimet e energjisë dhe është ndikuar nga rritja e fortë e çmimit të naftës. Rënia e çmimit të naftës në tetor dhe nëntor duket se ka sjellë ngadalësimin e inflacionit në këto vende më pas. Gjithashtu, kursi i këmbimit paraqitet i mbiçmuar në raport me një vit më parë, duke penguar përcjelljen e presioneve të jashtme në inflacionin në vend. Ndikimi i këtij faktori pritet të jetë i pranishëm edhe për pak tremujorë.

Zhvillimet ekonomike e financiare janë mbështetur, ndër të tjera, edhe nga politika monetare e Bankës së Shqipërisë. Stimuli monetar është përcjellë nëpërmjet ruajtjes së normës së interesit në nivelin 1.0%, furnizimit të tregut me likuiditet dhe ndërhyrjeve selektive në tregun e brendshëm valutor gjatë muajve të verës. Përdorimi i këtij instrumenti jotradicional dhe të përkohshëm ka rezultuar efektiv për frenimin e mbiçmimit të shpejtë të kursit të këmbimit, qetësimin e tregut valutor dhe zbutjen e ndikimit të tij negativ në arritjen e objektivit për inflacionin.

Grafik 2. Norma bazë e interesit (majtas) dhe ecuria ditore e kursit të këmbimit euro/lekë



Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

Tregjet e brendshme financiare kanë reaguar ndaj uljes së normës bazë të interesit, duke e pasqyruar atë në norma më të ulëta interesi në tregun ndërbankar dhe atë primar. Normat e interesit të kredisë në lekë mbeten në nivelet më të ulëta historike për të gjitha segmentet e produkteve. Ato kanë nxitur rritjen e vazhdueshme të kreditimit në lekë, duke bërë që kjo e fundit të jetë kontribuuesi kryesor i rritjes së kredisë për sektorin privat në pesë vitet e fundit. Në fund të muajit nëntor, kredia në lekë zë rreth 50.7% të kredisë në total, duke qëndruar rreth 1.5 pikë përqindje më lart se një vit më parë.

Grafik 3. Përcjellja e stimulit monetar në tregjet financiare



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rritja e kredisë për sektorin privat mbetet e ngadaltë, si pasojë e kreditimit të ulët të bizneseve. Analiza e ofertë-kërkesës për këtë segment tregon për një përqasje konservatore të bankave, të shprehur në standarde të shtrënguara

kreditimi, dhe për një kërkesë të ulët për kredi. Investimet e bizneseve janë financuar kryesisht nga të ardhurat e vetë biznesit. Nga ana tjetër, standardet e kreditimit të individëve tregojnë prirje lehtësuese, duke mbështetur zgjerimin me ritme të kënaqshme të kredisë për këtë segment. Banka e Shqipërisë pret përmirësim të ofertës së kredisë, pasi ulja e rrezikut të kredisë rrit aftësinë e bankave për të qenë më proaktive në kreditim[1].

Politika monetare stimuluese ka krijuar parakushtet për kthimin e inflacionit në objektiv. Nëpërmjet reduktimit të normave të interesit dhe primeve të rrezikut në tregjet financiare, dhe së fundmi edhe nëpërmjet frenimit të mbiçmimit të fortë të kursit të këmbimit, kushtet monetare reale janë lehtësuese. Ato mbështesin rritjen e kërkesës së brendshme dhe forcimin e presioneve inflacioniste.

Pritjet për zhvillimet ekonomike janë pozitive. Ekonomia parashikohet të qëndrojë në një trajektore rritëse, e mbështetur nga kushtet e favorshme financiare, besimi i agjentëve ekonomikë dhe përmirësimi i ambientit të jashtëm. Në afatin e mesëm, rritja e kërkesës agregate pritet të rritë përdorimin e kapaciteteve prodhuese pranë niveleve të tyre optimale, duke shtuar presionet e brendshme inflacioniste.

Banka e Shqipërisë parashikon se inflacioni mesatar vjetor do të luhatet rreth nivelit 2.1% gjatë vitit 2018, dhe do të kthehet në objektiv brenda vitit 2020.

Përditësimi i analizës dhe i parashikimeve në këtë raport sugjeron se rreziqet rreth vlerësimeve tona mbeten në kahun e poshtëm në horizontin afatmesëm. Ato lidhen me kohëzgjatjen, impaktin dhe kanalet e transmetimit të mbiçmimit të kursit të këmbimit në inflacion, me shpejtësinë e rikuperimit të kredisë bankare dhe me pasiguritë në ambientin e jashtëm. **Politika monetare do të vijojë të mbetet në kahun stimulues përgjatë horizontit afatmesëm, në mbështetje të nxitjes së rritjes ekonomike dhe të kthimit të inflacionit në objektiv.**

[1] *Raporti i kredive me probleme ndaj totalit ka zbritur në 12.7% në nëntor, nga 14.3% një vit më parë dhe 20.4% dy vjet më parë, dhe tregon për zbutjen e rrezikut të kredisë.*

3. AMBIENTI I JASHTËM I EKONOMISË

Rritja ekonomike botërore ka vijuar edhe në tremujorin e tretë e të katërt. Rritja ekonomike shfaqet më e shpejtë në SHBA dhe në vendet në zhvillim, ndërsa është ngadalësuar në Eurozonë. Tensionet e lindura si rezultat i masave mbrojtëse dhe tarifave tregtare të paraqitura nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë rreziqe që mund të ndikojnë klimën e përgjithshme ekonomike në të ardhmen.

Normat e inflacionit kanë regjistruar rritje në tremujorin e tretë dhe më pas janë ulur, si pasojë e ndryshimit në ecurinë e çmimit të naftës. Presionet afatmesme inflacioniste mbeten të moderuara, duke u reflektuar në norma të ulëta të inflacionit bazë. Politikat monetare të bankave kryesore sinjalizojnë fillimin e normalizimit të normave të interesit, por me shpejtësi të ndryshme. Divergjencat në intensitetin e zhvillimeve ekonomike dhe pritjet për kahun e politikës monetare të vendeve të zhvilluara kanë rritur rrezikun për rritjen e luhatshmërisë të tregjeve financiare.

3.1. EKONOMIA BOTËRORE

Rritja ekonomike në vendet kryesore të zhvilluara ka shfaqur ngadalësim në tremujorin e tretë dhe treguesit paraprijës sugjerojnë zbutje të rritjes ekonomike edhe në tremujorin e katërt. Rritja e PBB-së së vendeve anëtare të OBZHE-së u ul për të katërtin tremujor me radhë, në 2.4% nga 2.5% në tremujorin e dytë dhe 2.6% në tremujorin e parë, si pasojë e uljes së aktivitetit tregtar dhe të investimeve. Përjashtim nga kjo prirje bën vetëm SHBA-ja, ku stimuli fiskal ka mbështetur ritmet e përshpejtuara të rritjes. Norma e inflacionit ka shënuar rritje, e ndikuar nga çmimet e energjisë[2]. Papunësia ka shënuar rënie edhe poshtë niveleve të parakrizës dhe presionet nga pagat janë rritur, po ato nuk janë përcjellë ende në rritje të qëndrueshme të inflacionit bazë.

Shtrëngimi i kushteve monetare - veçanërisht në SHBA, pasiguria nga marrëdhëniet tregtare me Kinën, dhe tensionet financiare në vendet në zhvillim kanë rritur pasiguritë. Këtë e kanë reflektuar treguesit e ndjesisë ekonomike, të cilët shënojnë rënie në tremujorin e katërt.

[2] *Inflacioni vjetor i vendeve OBZHE (OECD) është 3.1% në muajin tetor, nga 2.9% në tremujorin e tretë.*

Grafik 4. Treguesi i përbërë paraprijës i PBB-së (CLI) dhe prodhimi industrial* i vendeve kryesore** (majtas); inflacioni i vendeve kryesore (djathtas)



*Prodhimi industrial është ndryshim mujor, ndërkohë që trendi afatgjatë i CLI është 100.
**Vendet e OBZHE-së (OECD) dhe Brazili, Kina, Rusia, India dhe Afrika e Jugut.
Burimi: OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik).

EKONOMIA E SHBA-SË

Ekonomia e SHBA-së u rrit me ritme të shpejta edhe në tremujorin e tretë të vitit, duke ruajtur trendin përmirësues të tremujorëve të mëparshëm. Rritja ekonomike u mbështet nga shpenzimet konsumatore, investimet jorezidenciale dhe shpenzimet e qeverisë qendrore. Nga ana tjetër, shpenzimet e qeverive lokale dhe investimet rezidenciale kanë shënuar një ngadalësim të ritmit të rritjes. Eksportet neto, të ndikuara nga tensionet mbi marrëveshjet tregtare, kanë kontribuuar negativisht, të shtyra si nga rënia e eksporteve, ashtu edhe nga rritja e importeve. Ekonomia vendase ka përfituar nga një kohë e gjatë politike monetare lehtësuese dhe stimujsh fiskalë, të cilat janë përkthyer në bilance të përmirësuara të kompanive dhe të ardhura të disponueshme më të larta. Papunësia vijon të regjistrojë ndër vlerat më të ulëta të dekadave të fundit. Tendenca pozitive e ekonomisë pritet të vijojë në periudhën në vijim, por tensionet tregtare, shtrëngimi gradual i politikës monetare dhe zbehja e efektit të stimujve fiskalë mund të sjellin një ngadalësim të ritmit të rritjes.

Inflacioni vjetor, pasi ndoqi një trajektore rënëse në gjysmën e parë të vitit, ka shënuar një rritje të lehtë në muajin tetor, i ndikuar kryesisht nga çmimet e karburantit. Ndërsa, norma e inflacionit bazë shënoi një ngadalësim të lehtë, duke iu afruar shënjestrës së Rezervës Federale.

Tabelë 1. Disa prej treguesve kryesorë makroekonomikë

Shtetet	Ndryshimi i PBB-së T3-2018		Norma e papunësisë (%)	Norma vjetore e inflacionit
	Tremujor	Vjetor	Tetor-2018	Nëntor-2018
SHBA	0.9	3.0	3.7	2.2
Eurozonë	0.2	1.6	8.1	2.0
Gjermani	-0.2	1.2	3.3	2.4
Francë	0.4	1.4	9.1	2.2
Mbretëri e Bashkuar	0.6	1.35	4.1	2.3

Burimi: Eurostat dhe institutet statistikore përkatëse.

EKONOMIA E EUROZONËS

Ekonomia e Eurozonës ka vijuar të rritet në tremujorin e tretë, ndonëse me ritme të ngadalësuara. PBB-ja në këtë tremujor rezultoi me rritje 1.7%, nga 2.1% në tremujorin e mëparshëm. Gjatë gjysmës së parë të vitit, kontributi i kërkesës së huaj ka ardhur duke u zvogëluar dhe ka vijuar të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike edhe në këtë tremujor. Rritja ekonomike është mbështetur tek kontributi pozitiv i shpenzimeve konsumatore dhe investimeve. Treguesit paraprakë të zhvillimeve ekonomike, si edhe ata të besimit, sugjerojnë vijimin e rritjes ekonomike edhe në tremujorin e fundit, por me ritme më të zbutura se në tremujorët e mëparshëm.

Pas dy muajsh rritjeje, inflacioni vjetor në muajin nëntor ra në 2.0%. Kjo lëvizje është pasojë e zbutjes së rritjes së çmimeve të energjisë, që vazhdojnë të jenë kontribuuesi kryesor në përbërjen e inflacionit. Inflacioni bazë vijon të jetë i ulët dhe presionet inflacioniste të qëndrueshme vlerësohen të përmbajtura.

Ekonomitë e dy vendeve kryesore partnere të Shqipërisë, **Italisë** dhe **Greqisë**, kanë shfaqur ritme të ndryshme në tremujorin e tretë të vitit. Ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në Itali është ndikuar në pjesën më të madhe nga frenimi i shpenzimeve konsumatore dhe i kërkesës së brendshme në përgjithësi. Ndër faktorët me ndikim pozitiv ka qenë kontributi i kërkesës së jashtme. Të dhënat paraprake nga tregtia me pakicë dhe vrojtimet e besimit tregojnë për zhvillime të ngjashme në aktivitetin ekonomik në tremujorin e fundit. Pasiguritë mbi buxhetin e ardhshëm fiskal dhe një ecuri më e ngadaltë ekonomike e Eurozonës pritet të jenë faktorë frenues të rritjes ekonomike të vendit në të ardhmen. Ekonomia greke shënoi përshpejtim të ritmit të rritjes në tremujorin e tretë të vitit. Analiza paraprake flet për një ndikim pozitiv të shpenzimeve të qeverisë, ndërkohë që shpenzimet konsumatore dhe eksportet neto nuk kanë ndryshuar kontributin e tyre në PBB. Aktiviteti ekonomik në Greqi pritet të vijojë të ndjekë një trajektore rritëse, i ndikuar nga gjallërimi i konsumit dhe zhvillimet pozitive të investimeve.

Grafik 5. Eurozonë: indeksi i përbërë i prodhimit dhe PBB-ja tremujore (majtas), ecuria e treguesve të vrojtimit të besimit (mes) dhe treguesi i ndjesisë ekonomike dhe PBB-ja vjetore (djathtas)



Burimi: Markit, Eurostat, KE.

Inflacioni vjetor në Itali arriti vlerën më të lartë të vitit në muajin nëntor, në 1.7%, i ndikuar nga ecuria e kategorisë së energjisë edhe produkteve të saj. Në Greqi, norma e inflacionit vjetor është rikthyer pranë normës e saj mesatare të vitit, duke shënuar 1.0% në muajin nëntor (nga 1.8% një muaj më parë). Në të dyja vendet, inflacioni bazë luhatet në vlera të ulëta, duke treguar për presione inflacioniste të përmbajtura.

EKONOMITË E RAJONIT[3]

Ekonomia e vendeve të rajonit ka vijuar të rritet me ritme të qëndrueshme edhe në tremujorin e tretë të vitit. Komponentët mbështetës të rritjes kanë qenë kryesisht ato të kërkesës së brendshme, ku shpenzimet konsumatore përbëjnë pjesën më të madhe të shpenzimeve në ekonomitë e rajonit. Përmirësime ka njohur dhe tregu i punës, ku norma e papunësisë është ulur - në rastin e Serbisë deri në minimumin historik. Ecuria pozitive ekonomike po përcillet ngadalë në çmimet në rajon. Presionet e brendshme inflacioniste mbeten të ulëta dhe ecuria e normave të inflacionit është e lidhur ngushtë me çmimet e energjisë dhe të ushqimeve.

Sikurse pritej, rritja vjetore e ekonomisë së **Turqisë** u ngadalësua ndjeshëm në tremujorin e tretë të vitit 2018 (në 1.6%, nga 5.3% në tremujorin e dytë), ndërsa pritet të rezultojë negative në tremujorin e katërt. Zhvlerësimi i lirës turke dhe rritja e normave të interesit janë reflektuar në uljen e konsumit privat dhe investimeve. Kontributi kryesor i ngadalësimit të rritjes erdhi nga tkurrja e sektorit të ndërtimit. Kursi i këmbimit ka rikuperuar pak nga nënçmimi prej 47% që ndodhi në gusht, megjithatë, efektet e krizës së kursit do të ndihen dhe vitin e ardhshëm. Ekonomia e **Kosovës** është rritur me 4.2% në gjysmën e parë të vitit 2018, e mbështetur kryesisht nga investimet në infrastrukturën e transportit. Shpenzimet private dhe ato qeveritare gjithashtu kanë kontribuuar në zgjerimin e aktivitetit ekonomik me ritëm të përshpejtuar.

Aktiviteti ekonomik në **Serbi** ka njohur ritme të larta dhe përtej parashikimit. Ekonomia është rritur 4.5% në 9-mujorin e vitit 2018, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ritmi i rritjes ekonomike u zbut në tremujorin e tretë, ndonëse mbeti përsëri mbi pritjet. Rritja ekonomike është mbështetur kryesisht nga investimet, të cilat janë rritur me norma dyshifrore, dhe nga shpenzimet konsumatore. Këto të fundit kanë përfituar nga përmirësimet në treguesit e punësimit. Pas disa tremujorësh të vështirë, ekonomia e **Maqedonisë** ka vijuar të rritet me ritëm të shpejtë edhe në tremujorin e tretë, si pasojë e zgjerimit të eksporteve, të konsumit publik dhe të konsumit privat. Investimet private kanë vijuar të tkurren, duke reflektuar pasigurinë që solli situata e tensionuar politike në pjesën e parë të vitit.

Normat e inflacionit vjetor në rajon kanë shfaqur vlera më të ulëta në muajt tetor dhe nëntor, pas rritjes në muajt e verës. Ecuria e inflacionit është diktuar

[3] *Vendet kryesore partnere tregtare që ndodhen jashtë Bashkimit Evropian (Kosovë, Maqedoni, Serbi, Turqi).*

në pjesën më të madhe nga çmimet e karburantit, energjisë dhe ushqimeve. Pritjet inflacioniste mbeten të ulëta në të gjithë rajonin. Përjashtim bën Turqia, ku norma e inflacionit, ndonëse është ulur në dy muajt e fundit, mbetet në vlera dyshifrore, ndikuar nga kursi i këmbimit.

Tabelë 2. Tregues ekonomikë për vendet fqinje

Vendet	Ndryshimi vjetor i PBB-së		Inflacioni vjetor	Norma e papunësisë
	T2 – 2018	T3-2018	Nëntor 2018	T3 - 2018
Itali	1.2	0.7	1.7	10.6
Greqi	1.7	2.2	1.0	18.6
Maqedoni	3.0	3.0	1.2	20.8
Serbi	4.9	3.8	2.2*	11.3
Turqi	5.3	1.6	21.6	11.1
Kosovë/1	3.5	4.7	2.1	29.4**
Shqipëri/1	4.5	4.3	1.8	12.9**

Burimi: Institutet statistikore përkatëse.
Shënim: 1/ Të dhënat për rritjen ekonomike të Kosovës dhe të Shqipërisë janë për tremujorin e parë dhe të dytë 2018;
**tetor 2018; **tremujori i dytë 2018.*

3.2. ÇMIMET E MALLRAVE KRYESORE NË TREGJET BOTËRORE

Indekset kryesore të mallrave shfaqën ecuri të ndryshme në tremujorin e tretë të vitit. Indeksi i çmimit të energjisë (ku përfshihen karburantet) regjistroi vlera të larta, ndërsa indeksi i çmimeve të ushqimeve dhe ai i metaleve ndoqi një trajektore rënëse. Çmimet e produkteve energjetike ndryshuan kah në muajin nëntor. Indeksi i çmimit të energjisë ka shënuar ngadalësim në normën e rritjes vjetore në 7% në muajin nëntor, nga mesatarisht 42% në muajt maj-tetor.

Tensionet gjeopolitike në zonën e Lindjes së Mesme, rajoni i cili është prodhues kryesor i naftës, të kombinuara me sasi më të vogla të ofruara nga vendet e kontinentit amerikan, rritën çmimin e naftës dhe të karburanteve në tregjet ndërkombëtare në tremujorin e tretë. Në muajin shtator, çmimi i naftës Brent në tregjet ndërkombëtare shënoi 78.9 $/fuçi, me një rritje vjetore prej 40.5%. Çmimi mesatar i naftës Brent ra në 65 usd/fuçi në muajin nëntor. Shqetësimet e tregjeve për mundësinë e një oferte më të lartë se kërkesa në vitin në vijim kanë ulur çmimin e këtij produkti në tregjet ndërkombëtare. Parashikimet e fundit të institucioneve që merren me studimin e tregut të energjisë sugjerojnë se çmimi i naftës do të qëndrojë rreth niveleve aktuale në tremujorët në vazhdim, dhe do të rritet lehtë në fund të vitit 2019[4].

Indekset e çmimeve të ushqimeve dhe metaleve vijuan të shënojnë vlera negative rritjeje vjetore edhe në tremujorin e katërt. Indeksi i çmimit të metaleve thelloi tkurrjen vjetore në nëntor (në 7%, nga 5% në tetor). Pritjet për nevoja më të ulëta për metale, në vendet ku prodhimi industrial zë një pjesë të rëndësishme të ekonomisë, kanë prodhuar një kërkesë më të ulët, e cila së bashku me

[4] *Parashikime të Energy Information Administration në SHBA: "Short term energy outlook", dhjetor 2018.*

tarifat për importet të vendosura nga SHBA-ja, ka tërhequr poshtë çmimet e metaleve në tregjet ndërkombëtare. Çmimet e ushqimeve shënojnë vlera më të ulëta, të ndikuara nga kërkesa më e ulët dhe tarifat e fundit mbi tregtinë e disa ushqimeve nga Kina mbi importet nga SHBA-ja.

Grafik 6. Ecuria e çmimit të naftës në tregun ndërkombëtar dhe vendas



Burimi: INSTAT, llogaritje të stafit; indekset e Bankës Botërore; parashikime të EIA.

3.3. TREGJET FINANCIARE

Siç pritej, në mbledhjen e shtatorit, FED-i ka rritur me 0.25 pikë përqindje intervalin objektiv të normës së interesit për fondet e saj, në 2.0% deri 2.25%. Në muajin gusht, edhe Banka e Anglisë rriti normën bazë të interesit me 0.25 pikë përqindje në nivelin 0.75%, si pasojë e zhvillimeve të forta pozitive në tregun e punës. Bankat e tjera kryesore qendrore nuk kanë ndryshuar normat bazë respektive: norma bazë e BQE-së mbetet 0.0%; dhe ajo e Bankës së Japonisë -0.1%. Kushtet monetare po shtrëngohen, pasi bankat po tërheqin stimulin monetar të krijuar nëpërmjet normave të ulëta të interesit apo lehtësimit sasior. FED-i ka deklaruar se do të vijojë të rrisë normën bazë të interesit, gjë që ka krijuar tërheqjen e flukseve të kapitalit nga vendet në zhvillim dhe ka sjellë luhatje të tregjeve financiare në këto vende. Banka Qendrore Evropiane ka deklaruar se do të ndërpresë programin e blerjes së obligacioneve në fund të këtij viti.

Grafik 7. Normat bazë të interesit të disa bankave qendrore



Burimi: Bankat qendrore (BQE, Fed, BJ dhe BA).

Në tregjet e kapitalit, *yield*-et e titujve qeveritarë të vendeve të zhvilluara kanë treguar një ecuri rritëse në tremujorin e tretë e të katërt. *Yield*-et qeveritare në SHBA dhe Mbretërinë e Bashkuar janë ndikuar

kryesisht nga ecuria e mirë ekonomike dhe pritjet pozitive të agjentëve. Në zonën euro, *yield*-et janë ndikuar nga pasiguritë e krijuara nga vlerësimi i titujve të Italisë. Kjo ka bërë që diferencat e titujve të shteteve me nevoja konsolidimi fiskal ndaj obligacioneve të Gjermanisë të rriten në këtë periudhë. *Yield*-et e obligacioneve të korporatave në tregjet e zonës euro janë rritur lehtas gjatë këtyre muajve, por gjithsesi mbeten poshtë vlerave të regjistruara para se të fillonte programi i blerjes së titujve të sektorit privat nga ana e BQE-së. Interesat e instrumenteve afatshkurtra në tregun e parasë në zonën euro nuk kanë ndryshuar, në përputhje me komunikimin e politikës monetare të BQE-së. Ato mbeten në nivele negative.

Euro është nënçmuar ndaj dollarit amerikan, duke reflektuar diferencat në politikat monetare të ndjekura nga këto dy ekonomi. Ndërkohë, euro është mbiçmuar ndaj monedhave të shumë shteteve kryesore dhe në zhvillim. Në terma mesatarë, euro u nënçmua me 2.35% ndaj dollarit amerikan në tremujorin e tretë, krahasuar me tremujorin e dytë. Në muajin nëntor, euro u këmbye me 1.137 dollarë amerikanë, duke qenë 3.2% më poshtë nga niveli i një viti më parë.

Grafik 8. Ecuria e disa treguesve financiarë në tregjet ndërkombëtare



Burimi: Bloomberg, Reuters dhe Eurostat.

4. TREGJET FINANCIARE DHE ZHVILLIMET MONETARE

Në tremujorin e katërt, tregjet financiare janë karakterizuar nga likuiditet më i lartë, norma interesi më të ulëta dhe rreziqe të përmbajtura. Emetimi i eurobondit në tregjet ndërkombëtare ndikoi në uljen e kërkesës së qeverisë për financim dhe kushtet e përmirësuara të likuiditetit kanë ndikuar në rënien e yield-eve. Ndërkohë, interesat e depozitave dhe ato të kredive kanë mbetur në nivele të ulëta. Në tregun valutor, leku është mbiçmuar ndaj monedhës evropiane dhe është nënçmuar ndaj dollarit amerikan.

Zhvillimet në portofolin e kredisë tregojnë për një ngadalësim të ritmeve të rritjes, të ndikuar si nga kërkesa e ulët për kredi nga bizneset, ashtu edhe nga standardet e shtrënguara të kreditimit për këtë segment. Kredia për individë vazhdon të udhëheqë rritjen e kredisë për sektorin privat, e mbështetur kryesisht nga kredia hipotekare. Sipas monedhave, ritmet më të larta të rritjes së kredisë në lekë kanë përkrahur zhvendosjen e mëtejshme të portofolit drejt një strukture më të balancuar valutore.

Kërkesa e pakët për para e agjentëve ekonomikë privatë dhe publikë vijon të kushtëzojë një ekspansion të dobët monetar dhe nuk sinjalizon ndryshime të presioneve monetare mbi inflacionin.

4.1. ZHVILLIMET NË TREGJET FINANCIARE

TREGU NDËRBANKAR

Normat e interesit në tregun ndërbankar janë luhatur pranë normës bazë në tremujorin e tretë dhe në muajt tetor e nëntor. Diferenca e interesave të tregut ndërbankar me normën bazë mbetet minimale. Kushtet e likuiditetit janë përmirësuar dhe kanë mbështetur këtë ecuri të normave të interesit. Volumi mesatar i tregtuar në këtë treg ka shfaqur tkurrje krahasuar me tremujorin e tretë, si rrjedhojë e zvogëlimit të shkëmbimeve javore. Maturitetet kryesore të përdorura mbeten ato ditore dhe javore, por krahas tyre vijojnë të përdoren edhe transaksionet 2-, 3- apo 30-ditore. Treguesit e luhatshmërisë[5] paraqiten pranë vlerave të tremujorit të kaluar, duke mbetur në nivele të ulëta.

[5] *Devijimi standard i normave ditore të interesit në tregun ndërbankar, për muajt tetor dhe nëntor, ishte 0.02, përkundrejt 0.04 në tremujorin e tretë të vitit 2018.*

Grafik 9. Operacionet e tregut të hapur të BSH-së dhe ecuria e normave të interesit në tregun ndërbankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ka vijuar të kryejë operacione injektuese të likuiditetit në sistem me anë të instrumentit të saj kryesor, repos 7-ditore. Krahas saj, janë shtuar edhe injektimet me repo me maturitet 3-mujor. Shuma e injektuar në këtë periudhë ka qenë mesatarisht më e vogël sesa ajo e tremujorit të tretë, ndërkohë që normat e interesit në ankandet e kryera kanë qëndruar pranë normës bazë.

TREGU I BRENDSHËM VALUTOR

Kursi i këmbimit të lekut ndaj monedhave të huaja vijon të shfaqet i mbiçmuar në krahasim me një vit më parë. Të dhënat nga sektori i jashtëm tregojnë për flukse të larta valutore në vend gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2018, duke mbështetur kahun mbiçmues të kursit të këmbimit. Paralelisht me to, ecuria e kursit të këmbimit ka qenë subjekt goditjesh veçanërisht në tremujorin e dytë të vitit, kur ndryshimi i sjelljes së agjentëve financiarë solli zhbalancim të raporteve të ofertës dhe kërkesës për valutë[6]. Këto goditje përshpejtuan ritmin e mbiçmimit të lekut duke e shmangur atë nga nivelet e sugjeruara nga faktorët fondamentalë dhe duke bërë të nevojshme ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor. Ndërhyrja e përkohshme e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor ka reduktuar zhbalancimet e ofertës dhe kërkesës për valutë, ka qetësuar funksionimin e tregut valutor dhe ka frenuar ritmin e shpejtë të mbiçmimit të lekut.

Kursi euro/lekë rezultoi i qëndrueshëm në tremujorin e tretë, për t'iu rikthyer tendencës mbiçmuese në tremujorin e katërt. Në muajt tetor e nëntor, kursi euro/lek u luhat në mesatarisht 124.9 lekë, duke u mbiçmuar me 0.9% krahasuar me tremujorin e tretë. Kjo ecuri duket të ketë reflektuar si nënçmimin e euros në tregjet ndërkombëtare, ashtu edhe praninë e ofertës së lartë për euro. Banka e Shqipërisë pothuajse nuk ka qenë e pranishme në treg gjatë

[6] *Një analizë më e detajuar gjendet në Raportin e Politikës Monetare 2018/III, të publikuar në muajin gusht 2018.*

kësaj periudhe. Krahasuar me një vit më parë, një euro është këmbyer me rreth 6.5% më pak lekë. Të dhënat e deritanishme të muajit dhjetor tregojnë se leku është mbiçmuar ndaj monedhës evropiane në mesatarisht 123.6 euro/lekë, në linjë me sjelljen e tij sezonale të fundvitit.

Grafik 10. Zhvillimet në tregun valutor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e lekut ndaj dollarit amerikan ka reflektuar luhatjet e kursit euro/usd në tregjet ndërkombëtare. Ecuria e mirë e ekonomisë amerikane, sinjalet për një normalizim më të shpejtë të normës së interesit nga Rezerva Federale, përkundrejt ngadalësimit të ekonomive evropiane, mbështetën forcimin e dollarit. Sikurse edhe në tremujorin e tretë, leku është nënçmuar ndaj dollarit gjatë muajve tetor-nëntor. Kështu, një dollar amerikan kushtonte mesatarisht 109 lekë, ose 0.9% më shumë se në tremujorin e tretë. Në terma vjetorë, mbiçmimi i lekut ndaj monedhës së gjelbër zbriti në 3.8%, përkundrejt mesatares prej 4.1% në tremujorin e tretë. Të dhënat e deritanishme të muajit dhjetor, tregojnë se leku është mbiçmuar ndaj dollarit amerikan në mesatarisht 108.8 lekë/usd.

Ecuria e indekseve të kompozuara të kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave kryesore të vendeve partnere tregtare, tregon për mbiçmim të monedhës vendase në tremujorin e katërt, të ngjashëm me atë të tremujorit të tretë. Gjatë kësaj periudhe, sipas kursit nominal efektiv (KNEK)[7], leku u mbiçmua mesatarisht me 9.9% vit mbi vit, ose rreth 3.6 pikë përqindje më shumë se mesatarja e gjashtëmujorit të parë. Ndërkohë, mbiçmim i lekut sipas indeksit të kursit real efektiv të këmbimit (KREK), shënoi një tkurrje mesatare vjetore prej 8.4%, përkundrejt 8.8% në tremujorin e tretë. Mbiçmimi i fortë i lekut ndaj shportës së monedhave, mbas muajit korrik, është ndikuar gjerësisht nga mbiçmimi i tij ndaj lirës turke, duke reflektuar zhvlerësimin e fortë të kësaj monedhe në tregjet ndërkombëtare.

[7] *Kursi nominal efektiv i këmbimit (KNEK/NEER) llogaritet kundrejt monedhave të pesë partnerëve tregtarë kryesorë (Itali, Greqi, Gjermani, Turqi dhe Kinë), duke përdorur peshat përkatëse në tregti. Me qëllim përllogaritjen e kursit lira/lek dhe renminbi/lek, kursi zyrtar referues mbetet ai i lirës turke dhe i renminbit kinez ndaj dollarit amerikan. Kursi real efektiv i këmbimit (KREK/REER) llogaritet në mënyrë të ngjashme si ai nominal, por merr parasysh edhe inflacionin në vend dhe në partnerët tregtarë.*

HAPËSIRË INFORMUESE 1: EFEKTI I NDËRHYRJEVE NË TREGUN VALUTOR[8]

Në mbledhjen e datës 6 qershor, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë miratoi përdorimin e ndërhyrjeve në tregun e brendshëm valutor, si instrument të politikës monetare. Në terma strategjikë, ndërhyrjet synuan shmangien e materializimit të efekteve negative që forcimi i shpejtë i kursit mund të kishte në inflacion në afat të mesëm. Në terma operacionalë, ai synonte krijimin e premisave për një aktivitet më normal tregtimi në tregun e brendshëm valutor. Gjykimi mbi efektivitetin e ndërhyrjeve mban parasysh këto objektiva. Mbështetur në informacionin e deritanishëm, premisat e para për përmbushjen e objektivit të parë duken pozitive. Megjithatë, vlerësimi i plotë i shkallës së përmbushjes së këtij objektivi do të kërkojë ende kohë. Nga ana tjetër, ndërhyrjet në tregun e brendshëm valutor kanë adresuar qëllimet lidhur me objektivin operacional.

Në aspektin operacional, prania e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor synonte të qetësonte sjelljen e agjentëve financiarë dhe pritjet e tyre për mbiçmim të mëtejshëm të kursit; të reduktonte pasigurinë në tregun valutor; dhe njëkohësisht të nxiste bankat të luanin rol aktiv në absorbimin e tepricës së ofertës në këtë treg. Analiza më poshtë tregon se Banka e Shqipërisë ka arritur të sigurojë një funksionim normal të tregut valutor.

Treguesi i parë i marrë në konsideratë është spread-i i çmimit të kuotuar të euro/lekë - diferenca midis çmimit të blerjes dhe të shitjes së euros - ku rritja e saj përfaqësonte pasigurinë e shtuar në tregun valutor. Kjo diferencë shënoi maksimumin në muajin qershor dhe më pas është ulur, duke iu rikthyer normalitetit. Rënia e pasigurisë është vërejtur si në ngushtimin e ndjeshëm të intervalit të shpërndarjes së spread-eve të kuotuara, ashtu edhe në uljen e nivelit mesatar të tij në tremujorin e tretë e të katërt. Kjo ecuri dëshmon për një qetësim të sjelljes së operatorëve financiarë në tregun valutor.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë inkurajoi bankat të marrin një rol më aktiv në absorbimin e goditjeve të tregut valutor, duke përcaktuar një ecuri normale të kursit edhe në mungesë të pranisë së saj. Pozicioni valutor i bankave tregtare tregon se gjatë tremujorit të tretë e të katërt, ato kanë akumuluar valutë në bilancet e tyre – duke u kujdesuar që të jenë në përputhje me kuadrin rregullativ. Ky tregues pasqyron se në ndryshim nga më parë, bankat kanë ndryshuar sjellje dhe kanë marrë pozicione të gjata në treg, duke u bërë më aktive në rolin e tyre si ndërmjetës në tregun

Grafik 11. Kursi ditor euro/lekë*



* Të dhënat janë deri në fund të nëntorit 2018.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 12. Ecuria e diferencës së çmimit të kursit euro/lekë kuotuar nga bankat tregtare (ne lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[8] *Në hapësirën informuese "Mbi ecurinë e kursit të këmbimit në gjysmën e parë të vitit 2018" në Raportin e Politikës Monetare 2018/III gjeni për tepër informacion mbi arsyet e vendimit për ndërhyrje në tregun valutor. Aty trajtohen dhe shqetësimet lidhur me funksionimin e tregut të brendshëm valutor.*

Grafik 13. Pozicioni i hapur valutor i sistemit bankar (në milionë euro – shmangie nga trendi dhe sezonaliteti)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 14. Luhatshmëria ditore e kursit euro/lek



Burimi: Banka e Shqipërisë.

valutor. Rikthimi i sjelljes së tyre në përputhje me sezonalitetin ka ndihmuar në qetësimin e presioneve për mbiçmimin e lekut në tregun valutor.

Një tjetër tregues që dëshmonte rritjen e pasigurisë në tregun valutor është dhe luhatshmëria ditore e kursit të këmbimit. Gjatë muajit qershor, devijimi standard i luhatjeve ditore kulmoi gati në 4.6 herë më shumë se mesatarja e pesë viteve të fundit. Prania e vazhdueshme e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor ndikoi në tkurrjen e ndjeshme të këtij treguesi dhe kthimin në normalitet të tij. Me uljen e pasigurisë dhe në sajë të rolit më aktiv të bankave në përcaktimin e çmimit të lekut ndaj monedhës evropiane, luhatshmëria ditore e kursit euro/lek është tkurrur edhe në periudhën kur Banka e Shqipërisë nuk ka qenë e pranishme në treg. Gjatë tremujorit të katërt, Banka e Shqipërisë pothuajse nuk ka qenë e pranishme në tregun valutor.

Sikurse dëshmon përmirësimi i treguesve të mësipërm, ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor kanë korrektuar çrregullimet afatshkurtra, të vëna re në tremujorin e dytë të vitit. Gjithashtu, nëpërmjet ngadalësimit të ritmit mbiçmues të kursit të këmbimit, rreziku i kursit të këmbimit mbi inflacion është zbutur.

TREGU PRIMAR

Në tregun primar të instrumenteve të borxhit të qeverisë, *yield*-et e **bonove** dhe të **obligacioneve** të thesarit kanë vijuar ecurinë rënëse gjatë gjithë tremujorit të tretë dhe në muajt e fundit të vitit. Rënia e *yield*-eve ka qenë e pranishme në të gjitha instrumentet dhe - duke përjashtuar muajin shtator - ajo ka vijuar me të njëjtën forcë në pjesën e dytë të vitit. Në ankandet e zhvilluara në muajin dhjetor, ulja e *yield*-eve vijoi përsëri. Në kushtet e mungesës së presioneve nga oferta e qeverisë, ecuria e *yield*-eve është përcaktuar nga kërkesa konkurruese e bankave, e cila ka qenë e lartë dhe ka drejtuar uljen e tyre. Emetimi i eurobondit nga ana e qeverisë në fillim të muajit tetor i ka krijuar hapësira kësaj të fundit për të zvogëluar kërkesën e financimit në tregun vendas.

Yield-i mesatar i bonove 12-mujore zbriti në 1.43% në muajin dhjetor nga 2.7% dhe 2.1%, që ishte respektivisht në fillim të vitit dhe në muajin qershor. *Yield*-et e obligacioneve kanë treguar ecuri të njëjtë me ato të bonove, por ulja e primeve të kërkuara ka qenë më e fortë, veçanërisht në maturitetin afatmesëm. Në ankandet e fundit të zhvilluara në muajt nëntor dhe dhjetor, *yield*-et e obligacioneve 2-, 5-, 7- dhe 10-vjeçare rezultuan respektivisht 1.94%, 3.80%, 5.02% dhe 6.48%, nga 2.40%, 5.13%, 5.45% dhe 6.80% që ishin në muajin korrik. Pjerrësia e kurbës së *yield*-eve është zbutur lehtas. Raporti i mbulimit të ankandeve të letrave të borxhit në këto muaj është rritur[9], duke konfirmuar sjelljen më konkurruese të bankave.

Grafik 15. Yield-et në tregun primar*



*Treguesi bid/cover për ankandet e bonove dhe obligacioneve të zhvilluara prej muajit korrik deri muajin nëntor rezultoi 1.54, nga 1.23 që ishte për gjysmën e parë të vitit.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[9] *Treguesi bid/cover për ankandet e bonove dhe obligacioneve të zhvilluara prej muajit korrik deri muajin nëntor rezultoi 1.54, nga 1.23 që ishte për gjysmën e parë të vitit.*

HAPËSIRË INFORMUESE 2: EMETIMI I TITULLIT REFERENCË 5-VJEÇAR

Prej muajit korrik, në kuadër të nismës së fundit të qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë për të zhvilluar tregjet financiare ka filluar të emetohet obligacioni 5-vjeçar referencë, si një projekt pilot. Prezantimi i këtij projekti ka për qëllim të zhvillojë tregun sekondar të letrave me vlerë. Nëpërmjet zhvillimit të tregut sekondar të letrave me vlerë, synohet të rritet likuiditeti i letrave afatgjatë të qeverisë, të përcaktohet një çmim sa më eficient për letrat me vlerë, si dhe të krijohet një normë referencë për ndërlidhjen e instrumenteve financiare në treg. Kuotimi i përditshëm i yield-it të kësaj letre me vlerë nga zhvilluesit e tregut rrit transparencën dhe bën të disponueshme në treg në kohë reale një informacion mbi çmimin e një instrumenti financiar "pa risk", i cili është i nevojshëm për përcaktimin e normave të interesit të instrumenteve financiare afatgjata. Ecuria në tre muajt e parë të këtij projekti tregon se ai ka dhënë rezultatet e para pozitive, si në drejtim të rritjes së volumit të tregtuar, ashtu edhe të rritjes së pjesëmarrësve në treg. Yield-i referencë, i cili kuotohet çdo ditë nga bankat e zgjedhura si zhvilluese tregu, ka shfaqur rënie.

Grafik 16. Ecuria e yield-it dhe volumet e kuotuara në tregun sekondar të obligacionit 5-vjeçar referencë*



*Në grafikun djathtas, MM- i referohet bankave të përzgjedhura si zhvilluese të tregut.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

4.2. NORMAT E INTERESIT TË DEPOZITAVE E TË KREDIVE DHE KUSHTET E FINANCIMIT

Normat e interesit të kredisë në lekë qëndrojnë në nivele të ulëta. Interesi mesatar prej 6.5% për **kredinë e re në lekë**, në muajt tetor-nëntor, rezultoi pranë vlerave mesatare të tremujorit të tretë (6.8%). Interesat e kredisë janë rritur tek maturiteti afatmesëm, ndërsa tek ai afatshkurtër dhe afatgjatë kanë shënuar zbritje të lehtë. Gjithsesi, krahasuar me gjysmën e parë të këtij viti, interesat e

kredisë janë lehtësisht më poshtë. Analiza sipas klientit evidenton se interesat e kredisë në lekë janë ulur më shumë për bizneset, ndërsa për individët ulja ka qenë marxhinale. Interesat e kredisë ndaj bizneseve janë ulur, si për nevoja likuiditeti, ashtu edhe për investime. Tek kreditë për individë, interesat janë ulur veçanërisht për kreditë hipotekare[10], ndërkohë që interesat për financimin e kredisë konsumatore kanë treguar ecuri të luhatshme. Diferenca e interesit mesatar të kredisë në lekë ndaj atij në euro është rritur lehtas këto dy muaj, kryesisht si rezultat i tkurrjes më të madhe së interesit të kredisë në euro sesa ajo në monedhën vendase. Diferencat e interesave të kredisë midis dy monedhave, sipas klientit, tregojnë rritjen e tyre për bizneset dhe tkurrjen për individët, veçanërisht tek kredia hipotekare.

Grafik 17. Normat e interesit për kredinë e re, mesatare rrëshqitëse 6-mujore



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesi mesatar për **kredinë e re në euro** në këta dy muaj ka shënuar ulje nga tremujori i tretë dhe gjysma e parë e vitit. Interesi mesatar i kësaj periudhe rezultoi 3.9%, nga 4.2% në tremujorin paraardhës. Ulja e interesave reflektoi zvogëlimin e tyre tek kategoria e bizneseve, si për nevoja likuiditeti ashtu edhe për investime. Ndërkohë, interesat e kredisë në euro për individë kanë treguar rritje, si për konsum ashtu edhe për kredinë hipotekare.

Rezultatet e vrojtimit të aktivitetit kreditues[11] për tremujorin e tretë tregojnë se bankat kanë shtrënguar lehtësisht kushtet joçmim për bizneset dhe i kanë lehtësuar ato për individë. Në ndryshim nga një tremujor më parë, kushtet joçmim për bizneset janë shtrënguar, si nëpërmjet uljes së madhësisë dhe maturitetit të kredisë së disbursuar, ashtu edhe nëpërmjet kërkesave më të larta për kolateral. Po kështu, në kahun shtrëngues ka qenë edhe ndryshimi i marzhit mbi kreditë me rrezik, duke konfirmuar se politikat e bankave për kreditimin e bizneseve mbeten të shtrënguara në tremujorin e tretë të vitit.

[10] *Norma e interesit për kredi hipotekare në lekë, në intervalin tetor-nëntor, rezultoi 3.44%, nga 3.6% që ishte në tremujorin e tretë dhe 3.8% në 6-mujorin e parë.*

[11] *Vrojtimi i aktivitetit kreditues zhvillohet 4 herë në vit me bankat e nivelit të dytë. E dhëna më e fundit disponibël është për tremujorin e tretë të vitit.*

Grafik 18. Kushtet e kreditimit joçmim për biznese (majtas) dhe individë (djathtas), balancë neto përgjigjesh



* Mesatare aritmetike e balancave neto të komponentëve përkatës.
Burimi: Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues, Banka e Shqipërisë.

Për kreditë për individë, bankat ndjekin një përqasje më të favorshme. Mesatarja e kushteve joçmim shfaqet lehtësisht në kahun pozitiv, duke reflektuar lehtësimin e kërkesave për kolateral nga bankat, në krahasim me një tremujor më parë, ndërkohë që bankat kanë shtrënguar lehtësisht madhësinë e kredisë. Paralelisht, kushtet çmim për individë janë pothuajse të pandryshuara nga një tremujor më parë. Gjithsesi, politikat e kreditimit të bankave ndaj individëve mbeten në kahun lehtësues.

Grafik 19. Normat e interesit për depozitat e reja në lekë edhe euro



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Interesi mesatar për **depozitat e reja me afat në lekë** rezultoi 0.9% në tremujorin e tretë dhe 0.97% në muajt tetor dhe nëntor. Brenda maturiteteve vihet re një rritje e lehtë e interesave tek maturitetet deri në një vit, ndërkohë që ato me maturitet 2 deri në 5 vjet nuk kanë ndryshuar. Interesat për **depozitat e reja me**

afat në euro janë luhatur rreth nivelit 0.17%, ndërsa niveli i tyre gjatë vitit 2018 luhatet rreth intervalit 0.10%-0.20%.

4.3. KREDITIMI I SEKTORIT PRIVAT[12]

Aktiviteti kreditues ka vijuar të shfaqë norma të moderuara rritjeje gjatë tremujorit të tretë e muajve tetor e nëntor. Ecuria e kredisë, gjatë kësaj periudhe, ka reflektuar zhvillimet e plogështa mujore të kredisë për biznese. Sipas vlerësimit të bankave[13], kërkesa për kredi e bizneseve në tremujorin e tretë raportohet më e ulët se një tremujor më parë, ndërkohë që kushtet kanë mbetur në kahun shtrëngues. Nga ana tjetër, kredia për individë ka vijuar të shfaqë rritje të qëndrueshme dhe të japë kontributin kryesor në zgjerimin e portofolit të kredisë. Megjithatë, portofoli i kredisë dominohet nga kredia për biznese, e cila përbën 66% të totalit. Në fund të muajit shtator, kredia për sektorin privat si raport ndaj PBB-së vlerësohet të jetë rreth 35.3%, e njëjtë me fundin e tremujorit të kaluar.

Teprica e kredisë për sektorin privat, në muajt tetor-nëntor, ka shfaqur ngadalësim të normave të rritjes vjetore në 0.9%. Rregulluar për mbiçmimin e monedhës vendase ndaj valutave kryesore, kjo normë luhatet rreth vlerës mesatare prej 4.5%[14], përkundrejt 4.9% të tremujorit të tretë. Në terma absolutë, stoku i kredisë për sektorin privat është rritur me rreth 4.3 miliardë lekë nga fundi i muajit shtator.

Grafik 20. Kredia për sektorin privat sipas monedhës dhe agjentëve ekonomikë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[12] *Të dhënat e kredisë janë të rregulluara për kreditë e nxjerra nga bilanci dhe nga lëvizjet e kursit të këmbimit.*

[13] *Për më shumë detaje, referojuni materialit mbi Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues për tremujorin e tretë të vitit 2018, i cili gjendet në adresën: https://www.bankofalbania.org/Politika_Monetare/Vrojtimet/Vrojtimi_i_aktivitetit_kreditues/*

[14] *Analiza e kredisë në këtë raport pasqyron shifra të rregulluara për efektin e nxjerrjes jashtë bilancit të kredive me probleme dhe luhatjet në kursin e këmbimit.*

Zhvillimet sipas monedhës evidentojnë rritje më të qëndrueshme të portofolit në lekë (6.2% v.m.v.). Pavarësisht ngadalësimit të normave të rritjes së këtij portofoli, krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit, ai vijon të japë kontributin kryesor në zgjerimin e kredisë për sektorin privat. Nga ana tjetër, kredia në valutë ka ngadalësuar ritmet e rritjes, rreth vlerës 3.2%, rregulluar për efektin e mbiçmimit të kursit të këmbimit. Ecuria e këtij portofoli karakterizohet nga një kërkesë më e luhatshme, veçanërisht në segmentin e bizneseve.

Kredia për biznese ka shfaqur ngadalësim të normës së rritjes në 3.2%, duke reflektuar ngadalësimin e ritmeve të rritjes së kredisë për investime në 5.6%, përkundrejt 6.4% në tremujorin e tretë. Megjithatë, zgjerimi vjetor i kredisë për biznese është mbështetur plotësisht nga rritja e kredisë për investime. Performanca e mirë e këtij portofoli në dy vitet e fundit ka ndikuar në zhvendosjen e strukturës drejt kredisë për investime, e cila përbën 57% të kredisë për biznese në muajin nëntor. Kredia për likuiditete vijon të mbetet e dobët, e ndikuar edhe nga gjendja e mirë e likuiditetit të bizneseve, sikurse vihet re nga rritja e depozitave të bizneseve gjatë vitit 2018.

Grafik 21. Kredia sipas qëllimit të përdorimit



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në muajt tetor-nëntor, kredia për individë ka shfaqur normë të ngjashme rritjeje vjetore me tremujorin e tretë, në rreth 7.8%. Pavarësisht se kjo normë është më e ulët se në gjashtëmujorin e parë të vitit, kredia për individë ka dhënë kontributin më të lartë në zgjerimin e kredisë për sektorin privat në terma vjetorë. E parë në një këndvështrim më afatgjatë, kjo ecuri lidhet me kushtet e lehtësuara të kreditimit në këtë segment, mbështetur dhe nga rritja e vazhdueshme e kërkesës. Kjo e fundit raportohet me rritje edhe gjatë tremujorit të tretë të vitit, si në segmentin konsumator, ashtu edhe në atë për blerje banese. Portofoli i kredisë konsumatore dhe i kredisë për blerje banese shënuan normë të njëjtë rritjeje, mesatarisht me rreth 7.8% për muajt tetor-nëntor. Në krahasim më gjashtëmujorin e parë të vitit, vihet re se dinamikat e rritjes të këtyre portofoleve janë shfaqur në

kahe të kundërta, kështu kredia për blerje banese ka përmirësuar ritmet e rritjes, ndërsa ajo konsumatore i ka ngadalësuar.

4.4. ECURIA E DEPOZITAVE DHE E PARASË NË EKONOMI

Oferta monetare në ekonomi ka shënuar ecuri të dobët gjatë vitit 2018. Norma mesatare vjetore e treguesit të parasë së gjerë, agregatit M3, shfaqet përgjithësisht në territor negativ, duke shënuar një normë vjetore prej -0.5% në muajin nëntor, të ngjashëm me mesataren e periudhës janar-tetor. Ecuria e këtij treguesi reflekton nga njëra anë efektin statistikor të mbiçmimit të monedhës vendase ndaj monedhave euro dhe usd, dhe nga ana tjetër ndryshimet strukturore të mbajtjes së parasë, ku zhvendosja e depozitave në maturitete mbi dy vjet[15] ka qenë e pranishme gjatë gjithë vitit. Rregulluar për këta dy faktorë, treguesi i parasë së gjerë tregon për një rritje mesatare rreth normës 2%. Nga ana tjetër, krijimi i ulët i parasë në ekonomi, reflekton financimin ende të dobët të sektorit privat me mjete monetare nga sektori bankar. Edhe treguesi i parasë në lekë, agregati M2, ka regjistruar norma vjetore tkurrëse gjatë vitit. Në muajin nëntor, ky tregues shënoi normë rënëse me 0.4% vit mbi vit, e njëjtë me mesataren e periudhës janar-tetor. Agregati likuid M1 është zgjeruar mesatarisht me rreth 5.3% në terma vjetorë (5% në muajin nëntor), duke pasqyruar preferencën e agjentëve ekonomikë për mjete monetare likuide. Raporti i parasë jashtë bankave ndaj agregatit M2 shënon 37.2% në fund të muajit nëntor, rreth 1.3 pikë përqindje më lart se në fund të vitit të kaluar.

Grafik 22. Ecuria e disa treguesve monetarë



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[15] *Sipas metodologjisë statistikore të ndjekur, depozitat me afat maturimi mbi dy vjet nuk përfshihen në llogaritjen e agregateve monetare.*

Stoku i depozitave në sistemin bankar është zgjeruar me rreth 1.1%[16] në terma mesatarë vjetorë, gjatë periudhës janar-nëntor 2018. Shtimi i depozitave është mbështetur si nga rritja e depozitave në lekë (1.3%), ashtu dhe nga ajo e depozitave në valutë (0.9%). Dinamika e zhvillimeve në depozita tregon për ngadalësim të ritmit vjetor të rritjes në muajin nëntor, si në monedhë vendase edhe në valutë.

Në terma të strukturës kohore, ecuria e depozitave ka vijuar të evidentojë zhvendosje të pjesshme drejt instrumenteve likuide, por zhvendosjet kryesore vërehen drejt depozitave me maturitete mbi dy vjet, veçanërisht në monedhën vendase. Kjo tendencë ka vazhduar edhe gjatë muajit nëntor. Kështu, depozitat në lekë me afat maturimi nën dy vjet janë reduktuar me rreth 24 miliardë lekë në periudhën janar-nëntor, ndërsa depozitat pa afat dhe ato me afat maturimi mbi dy vjet në lekë janë rritur përkatësisht me rreth 3 miliardë dhe 20 miliardë lekë. Nga ana tjetër, depozitat në valutë shënojnë rritje si në depozita pa afat, ashtu dhe në depozita me afat maturimi nën dhe mbi dy vjet.

Ecuria e depozitave sipas agjentëve ekonomikë tregon për rritje më të shpejtë të depozitave të bizneseve krahasuar me depozitat e individëve. Kjo prirje ka vijuar edhe në muajin nëntor, ku depozitat e bizneseve, pavarësisht një ngadalësimi të ritmit të rritjes, kanë shënuar një normë vjetore prej rreth 2.6%. Zgjerimi i depozitave të biznesit është kryesisht në trajtën e depozitave në valutë. Ndërkohë, stoku i depozitave të individëve në fund të muajit nëntor rezulton rreth 0.8% më i lartë se një vit më parë.

Grafik 23. Ecuria e depozitave në sistemin bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[16] *Rregulluar për efektin e kursit të këmbimit, norma mesatare vjetore e rritjes së tyre luhatet rreth vlerës 4%.*

5. INFLACIONI DHE RRITJA EKONOMIKE

Inflacioni mesatar shënoi vlerën 2.2% në tremujorin e tretë dhe 1.8% në muajt tetor e nëntor. Ecuria e inflacionit gjatë këtij viti ka gjetur një mbështetje më të mirë tek presionet e brendshme inflacioniste, të cilat kanë ardhur në rritje, si pasojë e përmirësimit ciklik të ekonomisë. Nga ana tjetër, mbiçmimi i vazhduar i monedhës vendase ka reduktuar presionet e jashtme inflacioniste.

Përmirësimi ciklik i ekonomisë është ndikuar nga përshpejtimi i rritjes ekonomike, e cila arriti nivelin 4.4% në gjashtëmujorin e parë të vitit 2018. Kushtet e favorshme të financimit, pritjet pozitive për të ardhmen, përmirësimi i gjendjes financiare, rritja e prodhimit të energjisë elektrike dhe e aktivitetit të turizmit, kanë qenë faktorët kryesorë të rikuperimit të kërkesës agregate. Këto zhvillime janë shoqëruar me rritje të punësimit e të pagave dhe rënie të normës së papunësisë. Në kushtet kur këto dinamika vlerësohet se do të vijojnë, procesi i kthimit të inflacionit në objektiv, në një horizont afatmesëm, është plotësisht i arritshëm.

5.1. ECURIA E INFLACIONIT

Inflacioni mesatar vjetor rezultoi 2.2% në tremujorin e tretë të vitit 2018, duke qëndruar në të njëjtin nivel me vlerën e shënuar në tremujorin e dytë. Norma e inflacionit ndoqi trend rënës gjatë muajve tetor dhe nëntor, përkatësisht në 1.9% dhe 1.8%. Kontribuuesit kryesorë në formimin dhe në luhatjet e inflacionit, gjatë periudhës korrik-nëntor të këtij viti, kanë vijuar të jenë mallrat ushqimore, veçanërisht ushqimet e papërpunuara. Për të njëjtën periudhë, kategoritë e

Grafik 24. Inflacioni vjetor dhe objektivi (majtas); inflacioni në vendet e rajonit dhe në BE (djathtas)



Burimi: INSTAT, www.tradingseconomics.com dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

shportës me çmime më pak të luhatshme kanë shënuar inflacion me dinamikë rritëse më graduale se sa në muajt paraardhës të vitit. Rritja e çmimeve të huaja ka qenë më e lartë gjatë periudhës në analizë, por përcjellja e saj është dobësuar nga mbiçmimi i kursit të këmbimit.

Kategoria **"Ushqime të papërpunuara"** u karakterizua nga norma në rënie të kontributit në normën e inflacionit, gjatë periudhës korrik-nëntor. Kjo përcaktoi edhe reduktimin e inflacionit total, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit[17]. Në periudhën tetor-nëntor vërehet një rënie e kontributit nga kjo kategori me rreth 0.3 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e tretë. Zhvillimet në çmimet e kësaj kategorie mund të shpjegohen nga një rritje e ofertës në terma mujorë dhe vjetorë, e ndikuar nga kushtet e favorshme të motit. Të dhënat e tregtisë së jashtme tregojnë se, veçanërisht në muajin tetor të këtij viti, ka pasur një rritje të importeve të fruta-perimeve shoqëruar me çmime në rënie.

Gjatë tremujorit të tretë dhe në dy muajt pasardhës, kategoria tjetër e mallrave ushqimore, ajo e **"Ushqimeve të përpunuara"**, ruajti kontributin e ulët pozitiv prej 0.2 pikë përqindjeje. Vërehet që nënkategoria "Bukë e drithëra", nga muaji gusht i këtij viti po regjistron norma vjetore negative të inflacionit.

Kategoria **"Mallra konsumi joushqimor"** kontribuoi në të njëjtën masë (0.3 pikë përqindje) në normën e inflacionit total për periudhën korrik-tetor. Çmimet e naftës pësuan rritje gjatë këtyre katër muajve, por kategoria ruajti thuajse të njëjtën masë kontributi, për shkak të rënies së çmimeve në disa nënkategori të tjera (p.sh. veshje e këpucë). Në muajin nëntor, kjo kategori kontribuoi më pak krahasuar me një muaj më parë (-0.1 pikë përqindje). Çmimet e naftës në tregjet ndërkombëtare kanë pësuar rënie gjatë këtij muaji. Në të njëjtën kohë, rënia e çmimeve u reflektua dhe në tregun vendas të karburanteve.

Grafik 25. Kontributet e grupeve ushqimore dhe joushqimore te norma e inflacionit, në pikë përqindje



Burimi: INSTAT dhe llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Çmimet e komponentëve më të qëndrueshëm të inflacionit, ku përfshihen kryesisht çmimet e shërbimeve dhe të mallrave të konsumit afatgjatë, kontribuuan më shumë në inflacionin total të periudhës në analizë. Brenda kategorisë **"Shërbime"**, çmimi i qirasë së imputuar ka ruajtur prirjen rritëse të vërejtur prej fillimit të vitit. Për rrjedhim, kontributi i kategorisë "strehim-qira" arriti në 0.5 pikë përqindje në muajin tetor. Kontributi i qirasë së imputuar pati një rënie të lehtë gjatë muajit nëntor, e para e vërejtur prej fillimit të vitit. Ky zhvillim reflektoi fillimin e shuarjes së efektit bazë, meqenëse rritja e çmimeve të kësaj kategorie ka filluar në muajin nëntor të vitit të kaluar.

[17] *Inflacioni në qershor rezultoi 2.4%, ndërkohë që në muajin nëntor, kjo normë u reduktua në 1.8%.*

Në muajt korrik dhe gusht u evidentua një tendencë rritëse e inflacionit të nëngrupit *"hotele, kafene e restorante"*, prirje kjo e munguar për këtë periudhë gjatë dy viteve të fundit. Rritje dyshifrore të inflacionit vjetor, në këta dy muaj, kanë pasur edhe çmimet e shërbimeve *"paketa turistike"*[18], duke ndikuar lehtësisht në rritjen e kontributit të kategorisë së shërbimeve. Me mbylljen e sezonit veror, çmimet e tyre pësuan uljen e zakonshme sezonale. Megjithatë, në muajin nëntor, rënia ishte më e theksuar në grupin e shërbimeve të transportit, duke bërë që kontributi i kategorisë "Shërbime" të bjerë me 0.1 pikë përqindje.

Kategoria e artikujve me **"Çmime të rregulluara"** vijon të japë kontribut pozitiv në inflacionin total që prej janarit të këtij viti (0.2 pikë përqindje), si pasojë e rritjes së çmimit të ujit në rrethin e Tiranës.

*Tabelë 3. Kontributi i kategorive kryesore në inflacionin vjetor (në pikë përqindje)**

	T1 16	T2 16	T3 16	T4 16	T1 17	T2 17	T3 17	T4 17	T1 18	T2 18	T3 18	Mes. Tet-Nën. 18
Ushqime të përpunuara	**-0.4**	**0.1**	**0.4**	**0.6**	**0.6**	**0.5**	**0.2**	**0.0**	**0.1**	**0.2**	**0.2**	**0.2**
Bukë dhe drithëra	-0.2	-0.1	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Alkool dhe duhan	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
Ushqime të papërpunuara	**1.5**	**0.9**	**1.2**	**0.9**	**1.3**	**1.1**	**1.2**	**1.3**	**0.9**	**1.1**	**1.0**	**0.7**
Fruta	0.7	0.6	0.4	0.2	0.3	0.3	0.5	0.6	0.6	0.1	0.0	-0.1
Perime	0.8	0.3	0.8	0.6	0.9	0.7	0.7	0.6	0.2	0.9	0.9	0.7
Shërbime	**-0.1**	**0.0**	**0.2**	**0.2**	**0.2**	**0.2**	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**
Mallra me çmime të rregulluara	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.2**	**0.2**	**0.2**	**0.2**
Furnizim me ujë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2
Strehim (qira)	**-0.2**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.1**	**0.1**	**0.2**	**0.3**	**0.4**	**0.4**	**0.4**
Mallra konsumi joushqimor	**-0.3**	**-0.3**	**-0.1**	**0.1**	**0.3**	**0.2**	**0.2**	**0.2**	**0.3**	**0.3**	**0.3**	**0.2**
Karburant	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.2	0.2
Mallra konsumi afatgjatë	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.1**	**0.0**	**-0.1**	**-0.1**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**	**0.0**
Indeksi i çmimeve të konsumit (ndryshim vjetor %)	**0.7**	**0.7**	**1.9**	**1.9**	**2.4**	**2.0**	**1.7**	**1.8**	**1.9**	**2.2**	**2.2**	**1.8**

Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.
**Në tabelë janë paraqitur disa nga grupet kryesore të kategorive.*

5.2. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO DHE ECURIA E KËRKESËS AGREGATE

Rritja ekonomike e tremujorit të dytë rezultoi 4.3%, një normë kjo lehtësisht më e ulët krahasuar me rritjen 4.5% të shënuar në tremujorin e parë. Edhe në tremujorin e dytë, rritja ekonomike u gjenerua në masën më të madhe nga sektori i industrisë, i ndikuar nga zgjerimi i fortë i prodhimit të energjisë elektrike. Sektori i shërbimeve shfaqi një kontribut të shtuar, ndërkohë që efekti i sektorit të ndërtimit vlerësohet në kahun rënës.

Analiza e komponentëve të kërkesës agregate tregon se rritja ekonomike vijoi të mbështetet nga kërkesa e brendshme, e drejtuar nga konsumi final i popullatës. Komponenti i investimeve llogaritet të ketë mbështetur rritjen ekonomike në një

[18] *Inflacioni i shërbimeve "paketa turistike", në muajt korrik dhe gusht, ishte respektivisht 12.2% dhe 14.7%. Pesha e tyre në shportën e IÇK-së është rreth 0.84%.*

masë më të vogël se një tremujor më parë. Eksportet neto dhanë një ndikim minimal në rritjen ekonomike të tremujorit.

Sipas informacionit të marrë nga treguesit paraprakë sasiorë, zhvillimet pozitive në degën e energjisë elektrike kanë vijuar edhe në tremujorin e tretë. Për sa i takon zhvillimeve në kërkesën agregate, konsumi vlerësohet të mbetet komponenti me kontributin kryesor në rritjen ekonomike. Kërkesa e brendshme pritet të vijojë të mbështesë rritjen ekonomike edhe në tremujorin e fundit të këtij viti.

5.2.1. PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO SIPAS SEKTORËVE[19]

Rritja ekonomike e shënuar në tremujorin e dytë vijon t'i atribuohet performancës së **sektorit prodhues**. Me gjithë rritjen me ritme më të ngadalta të vlerës së shtuar në prodhim - me 5.8% nga 7.5% një tremujor më parë - sektori prodhues kontribuoi me rreth 2.5 pikë përqindje në rritjen e PBB-së. *Aktiviteti në industri, energji dhe ujë* vazhdoi të drejtojë dinamikën e sektorit dhe kontributi i tij në rritjen vjetore të PBB-së llogaritet rreth 2.4 pikë përqindje, i njëjtë me atë të tremujorit të parë. Zgjerimi me 67.4% i vlerës së shtuar të energjisë elektrike vijoi të përcaktojë në një masë të konsiderueshme dinamikën pozitive të industrisë dhe të rritjes ekonomike në tërësi. Kontributi i degës së energjisë elektrike në rritjen reale të PBB-së llogaritet rreth 1.8 pikë përqindje në tremujorin e dytë, vlerë kjo e ngjashme me atë të tremujorit paraardhës (1.9 pikë përqindje).

Ngadalësimi i dinamikës rritëse së sektorit prodhues i atribuohet kryesisht tkurrjes së vlerës së shtuar në ndërtim, si edhe rritjes lehtësisht më të ngadaltë të aktiviteteve *"bujqësi, pyje dhe peshkim"*. Aktiviteti në ndërtim kontribuoi

Grafik 26. Produkti i brendshëm bruto nga ana e prodhimit dhe treguesit e besimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. *Të dhënat janë gjysmëpërfundimtare. **Një vlerësim i parë.

[19] *Ecuria e PBB-së dhe e vlerës së shtuar bruto sipas sektorëve trajtohet në terma të ndryshimeve vjetore reale. Analiza mbështetet në të dhënat më të fundit të PBB-së sipas metodës së prodhimit për tremujorin e dytë të vitit 2018, të publikuara nga INSTAT-i më 26 shtator 2018. Diferencat midis normave të rritjes së sektorëve të këtij publikimi dhe atyre të analizuara në Raportin e Politikës Monetare 2018/III janë rezultat i rishikimit të serive.*

negativisht në ecurinë vjetore të PBB-së, me 0.2 pikë përqindje. Ndërkohë, aktiviteti në bujqësi, pyje dhe peshkim, dha një kontribut lehtësisht më të ulët në rritjen ekonomike (në 0.3, nga 0.4 pikë përqindje në tremujorin e kaluar). **Sektori i shërbimeve** evidentoi ndërprerje të ecurisë ngadalësuese, duke shtuar kontributin në rritjen ekonomike gjatë këtij tremujori (1.6, kundrejt 1.1 pikë përqindjeje në tremujorin e parë).

Vlera e shtuar e **sektorit të industrisë, energjisë dhe ujit** shënoi rritje vjetore me 20.9% në tremujorin e dytë, një normë kjo lehtësisht më e lartë se ajo e tremujorit të kaluar. Kjo ecuri pasqyroi kryesisht zhvillimet pozitive në degën e *energjisë elektrike*. Zgjerimi i prodhimit të energjisë elektrike ka vijuar me ritme të larta edhe në tremujorin e dytë, duke dhënë një ndikim të konsiderueshëm në kahun rritës të kësaj dege.[20] Edhe dega e *industrisë përpunuese* përshpejtoi dinamikën rritëse vjetore në 11.2%, nga 9.9% një tremujor më parë.[21] Megjithatë, kontributi i saj në zgjerimin e sektorit, rreth 5.4 pikë përqindje, mbetet më i ulët krahasuar me kontributin e dhënë nga dega e energjisë elektrike. Ndërkohë, dega e industrisë nxjerrëse vijoi të shënojë tkurrje të vlerës së shtuar në terma vjetorë me 4.0%, duke e ndikuar ecurinë e sektorit në kahun rënës me 0.8 pikë përqindje.[22]

Grafik 27. Kontributet e degëve në ecurinë e vlerës së shtuar në "Industri, energji dhe ujë" dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në industri



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. *Të dhënat janë gjysmëpërfundimtare. **Një vlerësim i parë.

[20] *Dega e energjisë elektrike kontribuoi me 15.7 pikë përqindje në rritjen vjetore të sektorit të industrisë, nga 16.1 pikë përqindje një tremujor më parë. Sipas të dhënave tremujore të bilancit të energjisë elektrike, të publikuara nga INSTAT, prodhimi neto vendas i energjisë elektrike në tremujorin e dytë vazhdoi të rritet me ritme të larta vjetore, rreth 90.1%, nga 102.3% një tremujor më parë. Të njëjtën dinamikë shfaqi edhe indeksi i vëllimit të shitjeve neto në degën "Energji elektrike, gaz, avull dhe ajër i kondicionuar", duke u rritur në terma vjetorë me 38.2% në tremujorin e dytë, nga 49.2% një tremujor më parë. Indeksi i vëllimit të prodhimit për këtë degë përshpejtoi ecurinë rritëse vjetore në 52.3%, nga 43.8% një tremujor më parë.*

[21] *Midis nëndegëve të industrisë përpunuese, industritë tekstile, të veshjeve, të lëkurëve dhe këpucëve, si edhe industritë e lidhura me produktet metalike dhe ato bazë metalike vazhdojnë të mbështesin në masën më të madhe ecurinë e industrisë përpunuese, siç pasqyrohet edhe nga dinamika rritëse e eksporteve të produkteve të këtyre industrive.*

[22] *Si një industri e orientuar gjerësisht nga eksportet, rënia vjetore në vlerë e eksporteve të disa produkteve kryesore joenergjetike të lidhura me të vlerësohet të ketë ndikuar performancën e degës në kahun rënës.*

Sektori i industrisë pritet të ndjekë ecuri rritëse edhe në tremujorin e tretë. Ky vlerësim mbështetet nga vijimi i dinamikës rritëse të prodhimit të energjisë elektrike, nga rritja e indeksit të vëllimit të shitjeve neto në industri dhe rritja e disa eksporteve të produkteve të lidhura me aktivitete përkatëse në industri, si edhe nga rritja e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve në këtë sektor.

Grafik 28. Ecuria e vlerës së shtuar dhe norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e ndërtimit



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Sektori i ndërtimit thelloi tendencën ngadalësuese, duke shfaqur një dinamikë negative në tremujorin e tretë. Vlera e shtuar në ndërtim ra me 2.2% në terma vjetorë, pas rritjes me 2.4% një tremujor më parë.[23] Ecuria e sektorit të ndërtimit vlerësohet të jetë ndikuar kryesisht nga niveli më i ulët i investimeve publike, i ndikuar kryesisht nga baza e lartë krahasuese e një viti më parë. Kjo ilustrohet edhe nga rënia vjetore e vëllimit të punimeve inxhinierike.[24] Ndërkohë, rritja e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte, megjithëse me ritme më të ngadalta, si edhe vijimi i zgjerimit të investimeve të realizuara për ndërtime të reja, vlerësohet të kenë mbështetur ecurinë e sektorit të ndërtimit. Për sa u takon treguesve të tjerë të tërthortë sasiorë të lidhur me sektorin e ndërtimit, vlera e përafërt e lejeve të ndërtimit të miratuara ra në terma vjetorë për kategorinë e punimeve inxhinierike. Në të kundërt, ky tregues shënoi rritje për kategorinë e ndërtimeve për qëllime banimi dhe të ndërtesave të tjera.[25]

[23] *Kontraktimi i shënuar në sektorin e ndërtimit vlerësohet të ketë reflektuar në një masë edhe bazën më të lartë krahasuese një vit më parë. Në tremujorin e dytë të vitit 2017, vlera e shtuar në ndërtim u zgjerua me 19.5% në terma vjetorë, rritja më e lartë e shënuar për periudhën 2009–2017. Megjithatë, në një linjë me këtë ecuri ishin edhe sinjalet e dhëna nga tkurrja në terma vjetorë e indeksit të vëllimit të prodhimit në ndërtim dhe e indeksit të shitjeve neto në vëllim, me përkatësisht 3.0% dhe 4.9%.*

[24] *Sipas të dhënave të vlerës së përafërt të lejeve të ndërtimit sipas tipit të klientit, kategoria e punimeve inxhinierike realizohet në masën më të madhe nga klientët shtetërorë.*

[25] *Numri i lejeve të ndërtimit të akorduara në total për ndërtesa të reja, në tremujorin e dytë, rezultoi 270, nga 221 leje të miratuara një tremujor më parë. Ky numër vazhdoi të rritet, duke reflektuar kryesisht rritjen e numrit të lejeve të ndërtimit të akorduara për ndërtesa për qëllime banimi. Megjithatë, numri i tyre mbetet ende nën mesataren historike të tij. Në lejet e miratuara gjatë tremujorit të dytë, 180 ishin leje për ndërtesa për qëllime banimi, ndërsa 90 leje për ndërtesa të tjera (si hotele, zyra, ndërtesa tregtare, industriale e të tjera).*

Vlerësimet tona sugjerojnë për një përmirësim të ecurisë së sektorit të ndërtimit në tremujorin e tretë. Kjo sinjalizohet edhe nga rritja e indeksit të vëllimit të prodhimit e shitjeve neto në vëllim në këtë sektor, nga vijimi i rritjes graduale të numrit të lejeve të ndërtimit të miratuara për ndërtesa të reja dhe vlerësimet për një ndikim në kahun rritës të komponentit publik. Ndërkohë, prirja rënëse e treguesit të besimit dhe e shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve në ndërtim japin sinjale për ritme të moderuara rritjeje të sektorit në tremujorin e tretë.

Sektori i shërbimeve ndërpreu ecurinë ngadalësuese në tremujorin e dytë, duke shënuar rritje vjetore të vlerës së shtuar me 3.8%, nga 2.3% një tremujor më parë. Kjo performancë rezulton mbi mesataren historike të rritjes së sektorit dhe i atribuohet në masën më të madhe degës së *"Tregtisë, transportit, akomodimit dhe shërbimit ushqimor"*. Rritja e përshpejtuar e vlerës së shtuar të kësaj dege në 5.7%, nga 3.5% një tremujor më parë, u përkthye në një kontribut prej rreth 2.0 pikësh përqindjeje në rritjen e sektorit. Zhvillimet sipas degëve pasqyruan kryesisht dinamikën më të shpejtë rritëse të aktivitetit të lidhur me akomodimin dhe shërbimin ushqimor. Edhe degët e *"Aktiviteteve profesionale dhe shërbimeve administrative"*, *"Shërbimeve të tjera"* dhe *"Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit"* përshpejtuan ritmet vjetore të rritjes në terma të vlerës së shtuar, duke kontribuuar me përkatësisht 1.0, 0.5 dhe 0.2 pikë përqindje në ecurinë e shërbimeve. Ndikimi i dhënë nga *"Administrata publike, arsimi dhe shëndetësia"* në sektor llogaritet rreth 0.5 pikë përqindje, lehtësisht më i ulët se kontributi në tremujorin e parë. Për sa i takon kontributit të degës së *"Pasurive të paluajtshme"* në rritjen e sektorit, ai mbetet minimal, rreth 0.1 pikë përqindje. Ndërkohë, dega e *"Informacionit dhe komunikacionit"* vijoi të ndikojë ecurinë e shërbimeve në kahun rënës, duke kontribuar me -0.4 pikë përqindje.

Grafik 29. Kontributet e degëve dhe normat e shfrytëzimit të kapaciteteve në sektorin e shërbimeve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë. *Të dhënat janë gjysmëpërfundimtare. **Një vlerësim i parë.

Sektori i shërbimeve vlerësohet se ka vijuar dinamikën pozitive edhe në tremujorin e tretë. Kjo ecuri mbështetet nga sinjalet e marra nga rritja e treguesit të agreguar të shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve për aktivitetet e

shërbimeve. Megjithatë, niveli më i ulët i besimit në këtë sektor dhe baza më e lartë krahasuese e një viti më parë[26], kufizojnë përshpejtimin e ritmit të rritjes së vlerësuar të shërbimeve në tremujorin e tretë.

5.2.2. KËRKESA AGREGATE

Gjatë tremujorit të dytë 2018, kërkesa agregate pasqyroi norma rritjeje të krahasueshme me ato të tremujorit të parë të vitit. Nga ana e kërkesës së brendshme, ndikimet kryesore kanë buruar nga konsumi i popullatës, ndërsa investimet kanë ofruar një ndikim të ulët pozitiv. Kontributi i eksporteve neto ka rezultuar lehtësisht pozitiv, ndërsa ai i konsumit publik ishte negativ.

Informacionet nga tregues të tërthortë, dëshmojnë për një rritje ekonomike më të zbutur në tremujorin e tretë. Zgjerimi i pritur i konsumit të popullatës vlerësohet të mbetet kontribuuesi kryesor. Gjithashtu, pritet një ndikim pozitiv nga ana e eksporteve neto, ndërkohë që investimet vlerësohen me kontribut pozitiv, por të vogël. Sipas sinjaleve të marra nga treguesit paraprakë për tremujorin e katërt të vitit, konsumi dhe investimet vlerësohet të mbeten kontribuuesit kryesorë për rritjen ekonomike.

Kërkesa e brendshme u zgjerua me 2.4% në terma vjetorë në tremujorin e dytë të vitit 2018, normë kjo e ngadalësuar krahasuar me tremujorin e mëparshëm (3.3%). Ngadalësimi i normave të rritjes lidhet me zvogëlimin e ndikimit të investimeve dhe me një kontribut negativ nga ana e konsumit publik. Nga ana tjetër, konsumi i popullatës shënoi një normë rritjeje më të shpejtë krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018. Tregues paraprijës dhe të tërthortë sugjerojnë për vijim të rritjes së kërkesës së brendshme gjatë tremujorit të tretë dhe të katërt të këtij viti, në terma të ngjashëm me tremujorin paraardhës. Konsumi i popullatës pritet të japë kontributin kryesor, dhe formimi i kapitalit të japë një kontribut relativisht më të ulët pozitiv.

Grafik 30. Treguesi i ndjesisë ekonomike dhe struktura e kërkesës së brendshme



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[26] *Rritja vjetore e vlerës së shtuar në sektorin e shërbimeve rezultoi e lartë në tremujorin e tretë një vit më parë, rreth 5.6%.*

KONSUMI PRIVAT

Konsumi privat u zgjerua me 3.3% në terma vjetorë në tremujorin e dytë, lehtësisht më shumë se një tremujor më parë (3%). Prej dy vitesh, konsumi privat mbetet kontribuuesi kryesor i rritjes së kërkesës agregate. Gjykuar mbi tregues të tërthortë, të cilët japin informacion më të detajuar mbi kategoritë e konsumit, rritja e tij u mbështet nga një kontribut i shtuar i shpenzimeve për shërbime dhe për mallra të konsumit afatshkurtër[27]. Nga ana tjetër, tregues nga vrojtimet, por edhe ata sasiorë nga indeksi i tregtisë me pakicë, sugjerojnë se është ngadalësuar konsumi për mallra afatgjatë. Bazuar në vrojtimin e besimit të konsumatorit, balanca e blerjeve të mëdha është ulur dhe vijon të qëndrojë nën mesataren historike përkatëse, ndërkohë që balancat e tjera përbërëse të treguesit të besimit konsumator vijojnë të qëndrojnë mbi mesataren historike. Rritja e konsumit privat është mbështetur nga rritja e punësimit, të ardhurat nga remitancat dhe kredia për individë, në tremujorin e dytë. Gjithashtu, ajo është favorizuar nga ambienti me norma të ulëta interesi.

Grafik 31. Ecuria e konsumit privat dhe e indeksit të besimit konsumator



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Për tremujorin e tretë, priten norma rritjeje të konsumit privat të ngjashme me ato të dy tremujorëve të parë të vitit. Kjo është në një linjë me sinjalet pozitive të dhëna nga rritja e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe rritja e indeksit të vëllimit të shitjeve në tregtinë me pakicë. Ecuria pozitive e punësimit dhe rritja e remitancave janë faktorë që mbështesin vlerësimet për rritje të shpenzimeve konsumatore. Edhe tregues të tjerë afatshkurtër, si importi i automjeteve dhe kredia konsumatore, me gjithë ngadalësimin e shfaqur në tremujorin e tretë, mbeten në kahun rritës.[28] Ndërkohë, treguesi i besimit konsumator paraqitet me rënie në tremujorin në analizë, kryesisht për shkak të rënies së balancës së blerjeve të mëdha. Balancat e tjera përbërëse të këtij treguesi qëndrojnë mbi

[27] *Bazuar në tregues të dezagreguar të indeksit të tregtisë me pakicë dhe në vlerën e shtuar në sektorin e shërbimeve, pa përfshirë tregtinë.*

[28] *Ritmet më të zbutura të rritjes për të dy treguesit ndikohen në një masë edhe nga baza më e lartë krahasuese e një viti më parë.*

mesataren historike. Të dhënat e disponuara për ecurinë e konsumit privat në tremujorin e katërt janë të pjesshme, dhe mbulojnë zhvillimet për muajt tetor dhe nëntor. Rritja e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar gjatë muajve tetor e nëntor, dhe e importit të automjeteve gjatë muajit tetor, me ritme vjetore më të larta se normat e shënuara në tremujorin e tretë, sinjalizon për vijim të ecurisë rritëse të konsumit në fund të vitit. Nga ana tjetër, rënia e importit të ushqimeve, pijeve dhe duhanit gjatë muajve tetor e nëntor, dhe ngadalësimi i mëtejshëm i kredisë konsumatore gjatë muajit nëntor, sugjerojnë se rritja e konsumit privat në tremujorin e fundit pritet të mbetet e ngjashme me ecurinë e shfaqur gjatë pjesës së kaluar të këtij viti.

Grafik 32. Tregues të tërthortë sasiorë (majtas) dhe cilësorë (djathtas) për ecurinë e konsumit privat



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Grafik 33. Ecuria e formimit bruto të kapitalit fiks, ndryshime vjetore



Burimi: INSTAT.

INVESTIMET

Investimet shënuan rritje vjetore me rreth 1.5% në tremujorin e dytë, një normë kjo më e ulët se rritja prej 4.5% e një tremujori më parë. Kontributi i këtij komponenti në rritjen e kërkesës agregate u ul në 0.4 pikë përqindje, nga 1.0 pikë përqindje një tremujor më parë. Ecuria më e ngadaltë e investimeve totale në ekonomi u ndikua si nga komponenti publik, ashtu edhe nga ai privat.

Rritja e investimeve private në tremujorin e dytë vlerësohet të ketë reflektuar kryesisht rritjen e komponentit me natyrë jondërtimore, siç sugjerohet nga ecuria e importit të "Makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit".[29] Komponenti i investimeve të lidhura me ndërtimin rezulton të ketë frenuar ritmet e

[29] *Importi i këtij komponenti të investimeve rezultoi i rritur me ritme më të ngadalta vjetore, rreth 4.9% në tremujorin e dytë, pas rritjes me 15.5% në tremujorin e mëparshëm.*

rritjes, ecuri kjo e sinjalizuar nga treguesi i vlerës së shtuar dhe ai i importit të materialeve që përdoren në këtë sektor. Ecuria e këtij komponenti vlerësohet se reflekton në një farë mase dhe efektin e krahasimit me një bazë të lartë një vit më parë[30]. Përmirësimi i kërkesës konsumatore dhe kushtet e lehtësuara financiare mbeten faktorë mbështetës të kryerjes së investimeve private në ekonomi.

Treguesit e tërthortë sinjalizojnë se rritja e investimeve pritet të mbetet e ngadaltë edhe gjatë tremujorit të tretë të këtij viti, e ngjashme me tremujorin e mëparshëm. Kjo reflekton në një masë ecurinë e komponentit të investimeve me natyrë jondërtimore, siç sugjerohet nga importi i makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit[31], rënien e flukseve hyrëse të investimeve të huaja direkte në tremujorin e tretë dhe prirjen rënëse të gjendjes financiare të bizneseve. Ndërkohë, treguesit të cilët japin sinjale se ecuria e investimeve do të mbetet në kahun rritës janë rritja e shitjeve neto në vëllim në sektorin e ndërtimit dhe e kredisë për qëllime investimi. Investimet pritet të përmirësojnë dinamikën e tyre rritëse në tremujorin e katërt të këtij viti. Kjo trajektore është në një linjë me rritjen vjetore të importit të makinerive, pajisjeve e pjesëve të këmbimit, dhe të shpenzimeve kapitale të qeverisë në muajt tetor-nëntor. Ndërkohë, sipas të dhënave të tjera, si ato të kredisë për qëllime investimi, rritja më e zbutur e saj gjatë muajit nëntor mund të veprojë si faktor kufizues për ritmin e rritjes së pritur të investimeve në tremujorin e fundit të vitit.

Grafik 34. Tregues afatshkurtër të investimeve



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[30] *Në tremujorin e dytë një vit më parë, rritja vjetore e vlerës së shtuar në ndërtim rezultoi ndjeshëm e lartë, rreth 19.5%.*

[31] *Ky tregues ngadalësoi ritmin vjetor të rritjes, nga 4.9% në tremujorin e dytë në 0.0%, në tremujorin e tretë të vitit.*

KËRKESA E SEKTORIT PUBLIK DHE POLITIKA FISKALE[32]

Grafik 35. Orientimi i politikës fiskale, i përafruar nga ndryshimi i deficitit primar



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, INSTAT, llogaritje të stafit të Bankës së Shqipërisë.

Politika fiskale ka vijuar prirjen konsoliduese me nota edhe më të theksuara gjatë muajit tetor, kryesisht në sajë të një akumulimi më të lartë të të ardhurave buxhetore. Bilanci fiskal vijon të jetë pozitiv, rreth 1.5 miliardë lekë, duke gjeneruar në të njëjtën kohë një impuls negativ fiskal prej 1.5 pp të PBB-së[33].

Shpenzimet buxhetore për 10 muajt e parë të vitit përshpejtuan ritmin e rritjes vjetore në 2.4%, nga 1% në fund të nëntëmujorit. Rritja e totalit të shpenzimeve për këtë periudhë u formua në masën më të madhe nga zgjerimi i shpenzimeve për interesa (me kontribut prej 1.6 pp) dhe i atyre kapitale (1 pp kontribut). Trajektorja e rritjes së shpenzimeve buxhetore, gjatë këtij viti, reflekton pjesërisht edhe mungesën e shpenzimeve në trajtën e mbështetjes për sektorin energjetik.

Grafik 36. Ecuria e shpenzimeve sipas kontributeve të kategorive kryesore (majtas) dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë (djathtas) 2013 1M – 2018 10M



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Të ardhurat buxhetore kanë vijuar të ndjekin trajektore më të përmirësuar rritjeje që prej fundit të gjysmës së parë të vitit. Për 10 muajt e parë të vitit, të ardhurat totale shënuan një rritje me rreth 3.8% në terma vjetorë. Kontributin më të lartë në rritjen e totalit të të ardhurave e kanë dhënë të ardhurat nga sigurimet sociale (1.6 pp), të ardhurat nga TVSh-ja (1.1 pp), si edhe të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale (1.1 pp). Të ardhurat nga TVSh-ja kanë shfaqur një dinamikë më të përmirësuar pas gjysmës së parë të vitit. Kjo ecuri reflekton pjesërisht zbutjen e efektit negativ, si pasojë e mbiçmimit të monedhës vendase

[32] *Të dhënat fiskale të publikuara nga MFE-ja janë paraprake dhe janë subjekt rishikimi në të ardhmen.*

[33] *Impulsi fiskal është përafruar nga ndryshimi i raportit të balancës primare ndaj PBB-së, nga një vit më parë, duke konsideruar balancën primare kumulative për 12 muaj.*

kundrejt Euros, nga njëra anë, dhe dinamikën e përmirësuar të TVSh-së së mbledhur nga prodhimi i mallrave e shërbimeve në vend, nga ana tjetër. Ecuria e të ardhurave nga TVSh-ja, në tre muajt e fundit, mund të interpretohet si një kombinim sinjalesh pozitive, si për ecurinë e konsumit, ashtu edhe për një shtrirje më të gjerë të formalizimit në vend. Kjo e fundit, krahas përmirësimit të treguesve të tregut të punës, mbështetet edhe nga përmirësimi i ritmeve të rritjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, si edhe nga sigurimet sociale.

Grafik 37. Ecuria e të ardhurave sipas kontributeve të kategorive kryesore (majtas) dhe ndryshimet vjetore të zërave kryesorë tatimorë (djathtas) 2013 1M – 2018 10M



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Balanca buxhetore rezultoi me një suficit prej rreth 1.5 miliardë lekësh në fund të muajit tetor. Niveli i huamarrjes së brendshme u ruajt në rreth 29.4 miliardë lekë (nivel i njëjtë me nëntëmujorin dhe pothuajse ai i planifikuar për të gjithë vitin). Nga ana tjetër, me emetimin e Eurobondit me 500 milionë euro, niveli i huamarrjes së huaj u rrit në 32.1 miliardë lekë në tetor[34]. Vlerat pozitive të balancës fiskale nga njëra anë, si edhe zgjerimi i huamarrjes së qeverisë në tregun e huaj nga ana tjetër, sollën një rritje të tepricës së likuiditetit të qeverisë me rreth 33.3 miliardë lekë, vetëm për muajin tetor të këtij viti. Teprica e likuiditetit të qeverisë krijuar gjatë 10 muajve të këtij viti është rreth 63.1 miliardë lekë.

Grafik 38. Instrumentet e financimit të deficitit, në mld lekë, 2013 1M – 2018 10M



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

[34] *200 milionë euro u përdorën për shlyerjen e pjesshme të Eurobondit që maturohej në vitin 2020.*

KËRKESA E HUAJ DHE TREGTIA E JASHTME

Deficiti tregtar në mallra dhe shërbime u ngushtua në terma vjetorë realë, gjatë tremujorit të dytë 2018 (0.7%)[35]. Përcaktuesi kryesor në këtë zhvillim ka qenë rritja vjetore e eksporteve me rreth 3.9% dhe veçanërisht rritja e eksportit të mallrave me rreth 16.7%. Nga ana tjetër, është vënë re një zvogëlim në terma vjetorë i eksportit të shërbimeve me rreth 0.2%. Në rastin e importeve, rritja reale vjetore shënoi vlerën 2.0%. Kontribut kryesor për këtë ka dhënë rritja e importit të mallrave me 2.7%. Paralelisht, importi i shërbimeve u zgjerua me 0.6%, krahasuar me një vit më parë.

Grafik 39. Kontributi i eksporteve neto në kërkesën agregate (në pikë përqindje)



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

Përsa i përket tremujorit të tretë të vitit, është vënë re një ngushtim në terma vjetorë nominalë i deficitit tregtar në mallra, në masën 7.0%. Ecuria është përcaktuar kryesisht nga rritja e eksportit të mallrave me rreth 9.2% në terma vjetorë. Kjo normë ka rezultuar më e ngadaltë, nëse krahasohet me tremujorin e parë dhe të dytë të vitit (rritja vjetore e eksportit të mallrave shënonte respektivisht 18.9% dhe 17.9%). Rritja e eksporteve lidhet ngushtësisht me kategoritë "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike", ndikuar kryesisht nga eksporti i energjisë elektrike (ndikimi i energjisë elektrike në rritjen e eksporteve vlerësohet më i ulët, nëse krahasohet me gjysmën e parë të vitit 2018). Ndikimi pozitiv ka rezultuar gjithashtu nga "Lënda djegëse" dhe "Materiale ndërtimi dhe

Grafik 40. Orientimi i eksporteve dhe importeve sipas kategorive (vlera në milionë lekë)



Burimi: INSTAT.

[35] *Dinamika e deficitit tregtar në terma nominalë është e ndryshme nga ajo në terma realë. Nëse deficiti në terma realë u ngushtua vetëm me 0.7%, ngushtimi në terma nominalë raportohet në 17.2%. Diferenca lidhet me dallimet mes deflatorëve të eksportit dhe importit. Deflatorët e eksporteve vlerësohen pozitivë dhe relativisht të lartë, si për mallrat ashtu edhe për shërbimet që sinjalizon për rritje të çmimeve përkatëse në terma vjetorë. Nga ana tjetër, importet shfaqin deflatorë negativë, gjë që dëshmon për rënie të çmimeve të importit në terma vjetorë.*

metale". Në tremujorin e tretë të vitit është reflektuar edhe një pakësim i importeve me rreth 0.1% në terma vjetorë. Kontributet kryesore pakësuese kanë buruar nga kategoria "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike", si rrjedhojë e importeve në rënie të energjisë elektrike.

Të dhënat e tregtisë së jashtme për tremujorin e katërt të vitit, mbulojnë muajt tetor dhe nëntor. Statistikat dëshmojnë për një ngushtim të deficitit tregtar në mallra me rreth 8.2% në terma vjetorë. Ashtu si në tremujorin e tretë, ecuria është përcaktuar gjerësisht nga rritja e eksporteve me rreth 13.9%. Edhe në këtë periudhë, rritja e eksporteve është ndikuar kryesisht nga kategoria "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" dhe më konkretisht nga rritja e eksportit të "lëndës djegëse". Ndikime pozitive kanë buruar edhe nga kategoritë "Tekstile dhe veshje" dhe "Materiale ndërtimi dhe metale".

Grafik 41. Ecuria vjetore e çmimit të naftës (Dated-Brent), e eksportit të naftës vendase (majtas), e indeksit të çmimit të metaleve dhe e eksportit të metaleve vendase (djathtas)



Burimi: INSTAT, FMN, EIA, London Metal Exchange, Marketindex, Cameco.

Gjatë të njëjtës periudhë, importet e mallrave janë zgjeruar me rreth 1.7%. Ndikimet pozitive lidhen me kategoritë "Makineri, pajisje, pjesë këmbimi" dhe "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike".

Sipas orientimit gjeografik, vendet e Bashkimit Evropian dhe veçanërisht Italia mbeten partnerët kryesorë tregtarë, si në terma të eksporteve, ashtu edhe në terma të importeve. Rritja e eksporteve të lëndëve djegëse, energjisë elektrike dhe metaleve ka ndikuar në rritjen e peshave të partnerëve të tillë si Spanja, Kosova dhe Zvicra.

HAPËSIRË INFORMUESE 3: ZHVILLIMET NË BILANCIN E PAGESAVE NË TREMUJORIN E TRETË TË VITIT 2018

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 146.4 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2018, duke u zgjeruar me rreth 2.6% në nivel vjetor. Ai u vlerësua në nivelin 4.5% ndaj PBB-së nominale, rreth 0.4 pikë përqindjeje më e ulët se në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Përcaktues kryesor në këtë dinamikë ka qenë zgjerimi i të ardhurave parësore dalëse të lidhura me investimet direkte. Në të njëjtin drejtim ka ndikuar edhe nënllogaria e shërbimeve, e cila ka regjistruar një zvogëlim në terma vjetorë të suficitit përkatës. Kjo lidhet me një zgjerim më të shpejtë të importeve (krahasuar me eksportet), për shkak të shërbimeve dalëse të udhëtimit.

Kontribute në kahun ngushtues të deficitit korrent lidhen me nënkategoritë e të ardhurave dytësore dhe mallrave. Në rastin e parë, fenomeni lidhet me rritjen në terma vjetorë të të ardhurave hyrëse nga remitancat, por kryesisht nga transfertat e tjera personale. Në të njëjtin drejtim kanë ndikuar edhe të ardhurat hyrëse të sektorit publik. Për sa i përket nënllogarisë së mallrave, deficiti përkatës u ngushtua me rreth 1.8% në terma vjetorë, ndikuar më së shumti nga zgjerimi i shpejtë i eksporteve (me rreth 27.9%). Rritja e importeve rezultoi më e moderuar (4.0%). Në tërësi, deficiti tregtar i mallrave dhe shërbimeve u ngushtua me rreth 3.5% në terma vjetorë.

Në rastin e llogarisë financiare, flukset hyrëse të investimeve direkte neto u pakësuan në terma vjetorë me 21.1%. Për sa i përket financimit të deficitit korrent sipas profilit të flukseve, kontribut kryesor kanë pasur flukset joborxhkrijuese. Mjetet e rezervës janë zgjeruar me rreth 154.8 milionë euro.

Tabelë 4. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

	T1'17	T2'17	T3'17	T4'17	T1'18	T2'18	T3'18
Llogaria Korrente (në mil euro)	-157.5	-255.8	-142.8	-309.9	-170.7	-176.3	-146.4
vmv (%)	-20.4	-11.1	-3.9	74.5	8.4	-31.1	2.6
/ PBB-së (%)	-6.1	-8.4	-4.9	-10.2	-6.1	-5.2	-4.5
Mallra dhe shërbime	**-311.7**	**-486.7**	**-373.8**	**-570.2**	**-360.1**	**-428.9**	**-360.7**
vmv (%)	-22.7	-12.3	-9.0	30.5	15.5	-11.9	-3.5
Eksporte, f.o.b.	773.4	894.2	1110.0	875.6	840.0	1022.1	1238.8
vmv (%)	27.1	24.7	19.8	2.2	8.6	14.3	11.6
Importe, f.o.b.	1085.1	1380.9	1483.8	1445.8	1200.1	1451.0	1599.6
vmv (%)	7.2	8.5	10.9	11.7	10.6	5.1	7.8
Udhëtime neto	75.6	80.1	180.9	109.6	77.6	83.5	197.1
Të ardhura parësore	**-14.7**	**17.4**	**18.8**	**7.1**	**-13.4**	**13.7**	**-18.4**
Kredi	79.6	122.9	106.6	98.4	73.5	125.4	96.1
Debi	94.3	105.5	87.8	91.2	86.8	111.7	114.6
Të ardhura neto nga investimet direkte	-62.2	-81.8	-50.6	-46.4	-61.7	-89.1	-87.0
Të ardhura dytësore	**169.0**	**213.4**	**212.2**	**253.1**	**202.8**	**238.9**	**232.8**
Kredi	198.3	242.2	236.7	284.7	224.4	260.5	253.9
Debi	29.3	28.7	24.5	31.6	21.6	21.6	21.2
Dërgesa nga emigrantët -neto	135.1	162.7	165.8	172.1	148.6	181.7	170.0
vmv (%)	-0.5	5.7	3.9	4.1	10.0	11.7	2.6
Llogaria Kapitale	**23.8**	**25.3**	**30.4**	**42.9**	**18.3**	**21.2**	**22.9**
Huamarrje neto/Huadhënie neto	**-133.7**	**-230.6**	**-112.3**	**-267.1**	**-152.4**	**-155.1**	**-123.5**
Llogaria financiare	-295.9	-206.4	-222.3	-205.4	-287.9	-200.0	-11.1
vmv (%)	112.7	-22.7	144.2	72.0	-2.7	-3.1	-95.0
/ PBB-së (%)	-11.4	-6.7	-7.7	-6.8	-10.2	-5.9	-0.3
Investime direkte	**-206.4**	**-225.9**	**-340.2**	**-221.3**	**-291.0**	**-222.6**	**-268.5**
vmv (%)	63.3	-10.0	12.5	-13.8	40.9	-1.5	-21.1
Investime portofoli	-137.5	-21.6	31.2	27.9	3.5	110.6	13.1
Derivativë financiarë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	**39.4**	**117.3**	**49.1**	**-227.3**	**142.0**	**-173.2**	**89.5**
Mjetet e rezervës	**8.6**	**-76.2**	**37.6**	**215.4**	**-142.4**	**85.1**	**154.8**
Gabime dhe harresa	-162.2	24.2	-110.0	61.7	-135.5	-45.0	112.4

Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT .

5.3. GJENDJA CIKLIKE E EKONOMISË DHE PRESIONET INFLACIONISTE

Përditësimi i treguesve të gjendjes ciklike lë të pandryshuara vlerësimet se hendeku i prodhimit ka vijuar të ngushtohet, ndonëse mbetet në territor negativ. Përmirësimi i pozicionit ciklik të ekonomisë vlerësohet të ketë kontribuuar në rritjen graduale të presioneve të brendshme inflacioniste. Vijimi i përdorimit të faktorëve të prodhimit drejt një niveli optimal pritet t'i shtojë më shumë këto presione. Ndërkohë, mbiçmimi i kursit të këmbimit vijon të veprojë si faktor frenues në përçimin e plotë të presioneve inflacioniste të huaja.

Vijimi i përmirësimit të gjendjes ciklike të ekonomisë dhe zbutja e ndikimit nga kursi i këmbimit, pritet të ndihmojnë procesin e kthimit të inflacionit në objektiv në afatin e mesëm.

Analiza e informacionit të disponuar është në një linjë me vlerësimet tona se hendeku negativ i prodhimit po vazhdon tendencën drejt ngushtimit. Ecuria e treguesve kryesorë të tregut të punës, në tremujorin e tretë, vijon të japë sinjale pozitive për sa i takon përdorimit në shkallë më të lartë të faktorit "punë". Gjithashtu, shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve nga bizneset, në tremujorin e tretë, me gjithë luhatjet e shfaqura në periudhën afatshkurtër, sinjalizon përdorimin më intensiv të kapaciteteve prodhuese në ekonomi.

Grafik 42. Tregues të gjendjes ciklike të ekonomisë**



* Inflacioni bazë për tremujorin e katërt të vitit 2018 është mesatarja e normave vjetore për muajt tetor dhe nëntor.

** Hendeku i prodhimit është mesatare e disa matjeve mbi të cilën është aplikuar metoda e mesatares lëvizëse. Hendeku i normës së shfrytëzimit të kapaciteteve është llogaritur si devijim i vlerës aktuale nga mesatarja përkatëse historike për secilin prej sektorëve të Vrojtimit të Besimit të Biznesit. Më pas, hendeqet e sektorëve janë peshuar me peshat e tyre si në treguesin e ndjesisë ekonomike, dhe së fundmi është zbatuar metoda e mesatares lëvizëse me katër terma. Hendeku i shkallës së papunësisë vlerësohet si mesatare e hendeqeve të papunësisë sipas 3 metodave, të cilat vlerësojnë normën ekuilibër të papunësisë (NAIRU dhe NAWRU). Hendeku i shkallës së papunësisë është i shprehur si diferencë e shkallës ekuilibër të papunësisë me shkallën faktike të papunësisë dhe më pas zbatohet metoda e mesatares lëvizëse me katër terma.

Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Me gjithë tendencën drejt përmirësimit të kushteve ciklike, prania e kapaciteteve të lira në ekonomi kushtëzon forcimin e presioneve inflacioniste të brendshme. Njëkohësisht, mbiçmimi i kursit të këmbimit ka kufizuar rritjen e inflacionit të importuar. Vijimi i rritjes së kërkesës agregate, pakësimi i mëtejshëm i kapaciteteve të lira dhe frenimi i mbiçmimit të kursit të këmbimit, pritet të pasqyrohen në presione inflacioniste të rritura, duke kontribuuar në kthimin e inflacionit në objektiv në afatin e mesëm.

Zhvillimet në tregun e punës vijuan tendencën pozitive edhe në tremujorin e tretë të vitit. Punësimi në ekonomi u rrit me 2.3% në terma vjetorë, nga 3.3% në tremujorin e mëparshëm.[36] Dinamika pozitive e punësimit u mbështet në masën më të madhe nga sektorët e shërbimeve dhe të industrisë. Njëkohësisht, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës vijoi të rritet, duke qëndruar në 59.4%. Rritja e punësimit vazhdon të mbetet kontribuuesi kryesor për uljen e shkallës

[36] *Analiza e punësimit dhe e papunësisë mbështetet në të dhënat e Anketës Tremujore të Forcave të Punës dhe i referohet treguesve për popullsinë 15 vjeç e lart.*

së papunësisë në ekonomi.[37] Shkalla e papunësisë, rreth 12.2% në tremujorin e tretë, rezultoi më poshtë nivelit të shënuar si në tremujorin e mëparshëm (me 0.2 pikë përqindje), ashtu edhe një vit më parë (me 1.4 pikë përqindje). Këto zhvillime vlerësohet të kenë kontribuuar në përdorimin në shkallë më të lartë të faktorit "punë".

Norma e shfrytëzimit të kapaciteteve në ekonomi rezultoi rreth 72.4% në tremujorin e tretë të vitit. Kjo normë qëndron si mbi nivelin e shënuar në tremujorin e mëparshëm, me 0.3 pikë përqindje, ashtu edhe mbi nivelin e të njëjtës periudhë një vit më parë, me 1.4 pikë përqindje. Edhe ky tregues sugjeron për ngushtim gradual të kapaciteteve të lira në ekonomi.

Treguesi i kostove të punës për njësi[38] vijoi të ndjekë prirjen rritëse edhe në tremujorin e tretë të këtij viti, ndonëse me ritme më të zbutura. Më konkretisht, treguesi rezultoi i rritur me 1.3% në terma vjetorë, pas rritjes me 1.9% në tremujorin e mëparshëm. Ecuria e kostove të punës për njësi vazhdon t'i atribuohet tendencës rritëse - ndonëse me ritme të ngadalta - të treguesit përafrues të pagës mesatare reale për aktivitetet e mbuluara nga statistikat afatshkurtra.[39] Sipas të dhënave për pagën mesatare mujore për një të punësuar me pagë në vend, për tremujorin e tretë të këtij viti, ky tregues shënoi një rritje vjetore të ngjashme me tremujorin e mëparshëm (rreth 2.4%, nga 2.5% një tremujor më parë).[40] Pas deflatimit me inflacionin, rritja e pagës mesatare mujore për një të punësuar me pagë në ekonomi vlerësohet rreth 0.2%, nga 0.3% një tremujor më parë.

---

[37] *Në shqyrtimin e faktorëve që veprojnë në formimin e shkallës së papunësisë analizohen ecuria e punësimit, në kahun e kërkesës për punë, dhe shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës e popullsisë në moshë pune, në kahun e ofertës për punë.*

[38] *Treguesit përafrues të produktivitetit të punës, të kostove të punës për njësi të prodhuar dhe të pagës mesatare sipas aktiviteteve të statistikave afatshkurtra llogariten nga Banka e Shqipërisë, duke përdorur të dhënat e Statistikave Afatshkurtra (SASH, INSTAT, T3 2018). Në përllogaritjen e tyre përfshihen: indeksi i numrit të të punësuarve me pagesë, i shitjeve neto në vëllim dhe i fondit të pagave për aktivitetet e mbuluara nga anketa e SASH. Normat e raportuara të rritjes janë në terma realë dhe i referohen mesatares rrëshqitëse me katër terma të ndryshimeve vjetore të treguesit.*

[39] *Statistikat afatshkurtra mbulojnë aktivitetet në fushat e "Industrisë" (05 – 33), "Energjisë elektrike" (35), "Furnizimit me ujë, trajtimit dhe menaxhimit të mbetjeve"(36 – 39), "Ndërtimit" (41, 42, 43), "Tregtisë me pakicë dhe shumicë, e riparimit të automjeteve dhe motoçikletave" (45), "Tregtisë me shumicë, përveç automjeteve dhe motoçikletave" (46), "Transportit dhe magazinimit, përfshirë edhe aktivitetin postar dhe të korrierës" (49 – 53), "Akomodimit dhe shërbimit ushqimor, përfshirë vetëm Hotelet" (55.1), "Informacionit dhe komunikacionit"(58, 61, 62), "Aktiviteteve të arkitekturës dhe inxhinierike" (71) dhe "Agjencive udhëtimit"(79).*

[40] *Më 11 qershor 2018, INSTAT publikoi për herë të parë të dhënat për pagën mesatare mujore për një të punësuar me pagë në vend, me frekuencë tremujore. Seria e publikuar e të dhënave fillon që prej tremujorit të parë të vitit 2015. Ky tregues i referohet pagës mesatare mujore bruto dhe ka si burim të dhënat e listëpagesave të subjekteve nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në të përfshihen të gjitha aktivitetet ekonomike, si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat, për të gjithë punësuarit me pagë që punojnë në vend, duke përfshirë edhe rezidentët e huaj. Dinamika e këtij treguesi, në tremujorin e dytë të vitit 2018, pasqyroi në një masë edhe zbehjen e efektit pozitiv nga rritja e pagës minimale dhe e pagës mesatare në sektorin shtetëror një vit më parë. Më konkretisht, paga minimale zyrtare u rrit nga 22,000 lekë në 24,000 lekë në tremujorin e dytë të vitit 2017. Kjo rritje ishte 9.1% në terma vjetorë. Ndikimi i saj në kahun rritës për pagën mesatare në ekonomi, si rezultat i krahasimit me një bazë më të ulët, vlerësohet të jetë zbehur në tremujorin e dytë të vitit 2018.*

Grafik 43. Tregues të pagës mesatare në ekonomi (majtas) dhe ndryshimet vjetore mesatare të sheshuara të produktivitetit, të kostove të punës dhe të prodhimit (djathtas)*



*Mbi ndryshimet vjetore të treguesve janë zbatuar mesataret lëvizëse me 4 terma, për të zbutur luhatjet e rastit.
Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Të dhënat e **kostove të tjera prodhuese** dëshmojnë për rritje me ritme lehtësisht më të larta në tremujorin e tretë. Më konkretisht, çmimet e prodhimit industrial shënuan rritje vjetore me 2.8%, pas rritjes me 2.4% një tremujor më parë. Kjo ecuri pasqyroi kryesisht dinamikën më të shpejtë rritëse të çmimeve të eksportit, krahasuar me rritjen e çmimeve të prodhimit industrial për produktet në tregun vendas.

Vijimi i përmirësimit ciklik po përkthehet në një sensitivitet më të lartë të komponentëve afatgjatë dhe të brendshëm të inflacionit. **Inflacioni bazë dhe ai i mallrave të patregtueshme** të shportës së IÇK-së rezultuan përkatësisht 1.0% dhe 1.5% në tremujorin e tretë të vitit 2018. Ndërkohë, në muajt tetor dhe nëntor, inflacioni bazë shënoi mesatarisht vlerën 0.9% dhe ai i mallrave të patregueshme rezultoi rreth 1.9%. Përcjellja e presioneve rritëse nga ngushtimi i hendekut të prodhimit është materializuar në kontribute më të qëndrueshme

Grafik 44. Prirjet afatgjata të inflacionit (majtas) dhe prirjet afatshkurtra (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

të komponentëve afatgjatë dhe të brendshëm në inflacionin total. Rezistenca e këtyre komponentëve ndaj efekteve rënëse të mbiçmimit të kursit është rritur. Këto efekte vlerësohet të jenë përcjellë më shumë në inflacionin total përmes komponentëve afatshkurtër të tij. Për rrjedhim, **inflacioni jobazë dhe ai i artikujve të tregtueshëm** të shportës së IÇK-së shënuan vlera më të ulëta se një tremujor më parë, përkatësisht 5.3% dhe 2.6%. Për periudhën tetor-nëntor 2018, normat respektive shënonin 4.4 dhe 1.8%, duke vijuar rënien.

Treguesi i presioneve të huaja (TPH)[41] u ngushtua mesatarisht me 1.0% në terma vjetorë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2018. Edhe në këtë tremujor, dinamika e çmimeve të huaja dhe e kursit të këmbimit ka qenë e kundërt, por me magnitudë pothuajse të njëjtë. Kështu, mbiçmimi i kursit nominal efektiv të këmbimit në terma vjetorë shënoi 9.8%, ndërsa zgjerimi vjetor i "Indeksit të Çmimeve të Huaja" (IÇH)[42] ishte rreth 9.0%. Efekti i kursit të këmbimit në treguesin e presioneve të huaja mbizotëroi dhe ky tregues u zvogëlua në terma vjetorë, duke mbetur në territor negativ për një kohë të gjatë.

Zhvillimet në periudhën tetor-nëntor janë të ngjashme me atë të tremujorit të tretë; me simetri të kundërt ndërmjet çmimeve të huaja dhe kursit nominal efektiv të këmbimit. Zgjerimi i "Indeksit të Çmimeve të Huaja" rezultoi rreth 8.4% dhe mbiçmimi i kursit nominal efektiv ishte 10.2%. Si rrjedhojë, TPHI-ja u zvogëlua me 1.9% në terma vjetorë, si pasojë e mbizotërimit të efektit të kursit të këmbimit.

Grafik 45. TPHI-ja dhe kontributet e përbërësve të tij (majtas); kontributi i inflacionit të importuar dhe të brendshëm në atë total vjetor (djathtas)



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

[41] *Është një tregues përafrues mbi presionet e huaja inflacioniste, i cili agregon informacionin nga indekset e çmimeve të huaja (IÇH) me atë të kursit të këmbimit në terma nominalë efektivë (KNEK). TPHI-ja llogaritet si rritje vjetore e IÇH-së dhe e KNEK-ut për periudhën përkatëse. TPHI-ja vlerësohet që ndikon me rreth 5 muaj vonesë inflacionin vendas.*

[42] *Është një tregues përafrues mbi presionet e huaja inflacioniste, i krahasueshëm me inflacionin e sektorit të tregtueshëm të mallrave të shportës së IÇK-së vendase. Indeksi i çmimeve të huaja bazohet në vlerat e: inflacionit të kategorisë "Ushqim, pije, duhan" për 18 shtete kryesore; dhe inflacionit të "Mallrave" (pra, jo vetëm Ushqime) për Bullgarinë, Gjermaninë, Greqinë, Italinë dhe Turqinë.*

Zhvillime të ngjashme konfirmohen edhe nga përqasja e dekompozuar e inflacionit total, në të importuar dhe në të brendshëm. Presionet e importuara inflacioniste kanë dhënë një kontribut më të ulët se më parë në inflacionin total, gjatë tremujorit të tretë të vitit (0.9 pikë përqindje). Kontributet janë pakësuar edhe më tej në muajt tetor-nëntor 2018 (0.3 pikë përqindje). Ky zhvillim, në kushtet kur çmimet e huaja kanë qenë në rritje, sugjeron një përcjellje më të plotë të efekteve të mbiçmimit të monedhës vendase, përmes kanalit të inflacionit të importuar tek ai total. Gjatë të njëjtës periudhë, presionet e brendshme inflacioniste kanë siguruar kontribute kompensuese në kahun rritës. Kontributi i inflacionit të brendshëm arriti në 1.3 pikë përqindje në tremujorin e tretë dhe 1.5 pikë përqindje në tetor. Ndonëse nuk është tërësisht i izoluar nga sjellja e kursit, duket se ai po asimilon më mirë presionet e shtuara nga përmirësimi ciklik.

PRITJET PËR INFLACIONIN[43]

Bazuar në të dhënat më të fundit të vrojtimit të agjentëve financiarë, pritjet afatshkurtra për inflacionin janë rishikuar për poshtë me 0.1 pikë përqindje në tremujorin e katërt. Pritjet afatmesme kanë mbetur të pandryshuara këtë tremujor, në krahasim me tremujorin e tretë të vitit.

Gjatë tremujorit të tretë, pritjet e agjentëve të ndryshëm të ekonomisë u rishikuan në kahe të ndryshme. Pritjet afatshkurtra të konsumatorëve dhe pritjet e agjentëve financiarë, për të tre horizontet kohore të pyetura, u rishikuan për lart. Pritjet afatshkurtra të bizneseve u rishikuan për poshtë këtë tremujor.

Grafik 46. Pritjet inflacioniste, ndryshime vjetore në përqindje*



*) Pritjet e agjentëve financiarë për tremujorin e katërt 2018 janë përafruar nga mesatarja aritmetike e vlerave të muajve tetor dhe nëntor 2018.
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

[43] *Analiza mbi pritjet inflacioniste bazohet në rezultatet e vrojtimit të besimit të bizneseve dhe të konsumatorëve, si dhe në vrojtimin e pritjeve të agjentëve financiarë. Dy grupet e para shprehen për pritjet për inflacionin pas një viti.*

SHTOJCA STATISTIKORE	fq/pg	STATISTICAL APPENDIX
Tregues të përgjithshëm makroekonomikë	58	Main macroeconomic indicators
1. Zhvillimet monetare dhe normat e interesit	58	Monetary developments and interest rates 1.
2. Prodhimi i brendshëm bruto, indekset e çmimeve dhe tregu i punës	58	Gross domestic product, price indexes and labor market 2.
3. Bilanci i pagesave, rezerva dhe kursi i këmbimit	59	Balance of payments, reserves and exchange rate 3.
4. Bilanci fiskal, stoku i borxhit të brendshëm dhe borxhi i jashtëm	59	Fiscal balance, domestic debt stock and external debt 4.
	59	
1 SEKTORI FINANCIAR	60	FINANCIAL SECTOR 1
1-1 Bilanci sektorial i Bankës së Shqipërisë	60	Sectoral balance sheet of Bank of Albania 1-1
1-2 Paraqitja monetare e Bankës së Shqipërisë	61	Monetary survey of Bank of Albania 1-2
1-3.a Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Mjetet	62	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Assets 1-3.a
1-3.b Bilanci sektorial i bankave paradepozituese/ Detyrimet	63	Sectoral balance sheet of deposit money banks/ Liabilities 1-3.b
1-4 Paraqitja monetare e bankave paradepozituese	64	Monetary survey of deposit money banks 1-4
1-5 Bilanci sektorial i shoqërive të kursim-kreditit	65	Sectoral balance sheet of savings and loan associations 1-5
1-6 Paraqitja monetare e korporatave të tjera depozituese	66	Monetary survey of other depository corporations 1-6
1-7 Paraqitja monetare e korporatave depozituese	67	Monetary survey of depository corporations 1-7
1-8.a Agregatët monetarë dhe përbërësit e tyre	68	Monetary aggregates and their components 1-8.a
1-8.b Kundërpartitë e agregatëve monetarë	69	Counterparts of monetary aggregates 1-8.b
1-9 Depozitat në lekë sipas sektorëve	70	Lek denominated deposits by sectors 1-9
1-10 Depozitat në valutë sipas sektorëve	70	Foreign currency denominated deposits by sectors 1-10
1-11 Kredia për ekonominë sipas sektorit	71	Credit to economy by sector 1-11
1-12 Huatë e korporatave jofinanciare sipas aktivitetit ekonomik (NVE - Rev.2)	72	Loans of non-financial corporations by economic activity (Nace - Rev.2) 1-12
1-13a Huatë e korporatave jofinanciare private sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	73	Private non-financial corporations loans by purpose and currency 1-13a
1-13b Huatë e korporatave jofinanciare publike sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	74	Public non-financial corporations loans by purpose and currency 1-13b
1-14 Huatë e Individëve dhe Institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	75	Households + Non-profit institutions serving households loans by purpose and currency 1-14
1-15 Huatë sipas rretheve	76	Loans by districts 1-15
1-16 Normat e interesit të Bankës së Shqipërisë	77	Bank of Albania interest rates 1-16
1-17 Normat e interesit për depozitat e reja të korporatave jo-financiare, individëve dhe institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas monedhave	78	Interest rates on new deposits of non-financial corporations, households and NPISH by currency 1-17
1-18 Normat e interesit për huatë e reja të korporatave jo-financiare, individëve dhe institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve sipas monedhave	79	Interest rates on new loans of non-financial corporations, households and NPISH by currency 1-18
1-18a Normat e interesit për huatë e reja të korporatave jofinanciare private sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	80	Interest rates on new loans of private non-financial corporations by purpose and currency 1-18a
1-18b Normat e interesit për huatë e reja të individëve dhe institucioneve jo me qëllim fitimi që u shërbejnë individëve, sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës	81	Interest rates on new loans of households and NPISH by purpose and currency 1-18b
1-19 Normat e interesit për bonot e thesarit sipas afatit	82	Maturity breakdown of Treausury bills yields 1-19
1-20 Statistika të sistemit të pagesave	83	Payment systems statistics 1-20
1-21 Shpërndarja rajonale e terminaleve të bankave ATM & POS	83	ATM & POS bank terminals' distribution of by regions 1-21
1-22 Numri i llogarive të klientëve në banka	83	Number of customers accounts with banks 1-22
2 SEKTORI I JASHTËM	84	EXTERNAL SECTOR 2
2-1 Bilanci i Pagesave	84	Balance of payments 2-1
2-2 Kurset e këmbimit të lekut kundrejt monedhave kryesore	85	Exchange rate 2-2
2-3 Eksporti sipas grup mallrave	85	Export by commodity groups 2-3
2-4 Importi sipas grup mallrave	86	Import by commodity groups 2-4
2-5 Borxhi i jashtëm bruto	86	Gross external debt 2-5
3 SEKTORI FISKAL	87	FISCAL Sector 3
3-1 Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar	87	Fiscal indicators regarding consolidated budget 3-1
3-2 Stoku i borxhit të brendshëm sipas instrumenteve	88	Domestic debt stock by instruments 3-2
4 SEKTORI REAL	89	REAL SECTOR 4
4-1 Prodhimi i brendshëm bruto sipas klasifikimit të aktivitetit ekonomik, (Metoda e Prodhimit NVE Rev 2)	89	Gross domestic product by economic activities, (Production Method NACE Rev 2) 4-1
4-2 Indeksi i çmimeve të prodhimit dhe indeksi i kushtimit në ndërtim	90	Producer price index and construction cost index 4-2
4-3 Indeksi i çmimeve të konsumit	91	Consumer price index 4-3
4-4 Punësimi, papunësia dhe pagat	92	Employment, unemployment and wages 4-4

TREGUES TË PËRGJITHSHËM MAKROEKONOMIKË
1. ZHVILLIMET MONETARE DHE NORMAT E INTERESIT
Në miliardë lekë, përveç rasteve kur shënohet ndryshe, fund periudhe

MAIN MACROECONOMIC INDICATORS
MONETARY DEVELOPMENTS AND INTEREST RATES 1.
In billions ALL, unless otherwise indicated, end of period

	Agregatët monetarë / Monetary aggregates			Depozitat [2]/ Deposits [2]	Kredia [3] / Credit [3]	Normat e interesit 12m / 12m interest rates (%)			Norma e marrëveshjes së riblerjejes njëjavore [5] / Weekly repurchase agreement rate[5]
	M1	M2	M3			Depozita[4] / Deposits[4]	Hua [4] / Loans[4]	Bono Thesari [5] / T. Bills [5]	
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2014	353.3	722.4	1,195.1	977.4	560.0	1.92	7.66	3.33	2.25
2015 [1]	384.1	723.0	1,216.2	985.6	546.8	1.35	7.77	2.40	1.75
2016	435.4	736.9	1,263.5	1,014.0	547.2	0.80	5.89	2.92	1.25
2017	461.6	738.9	1,266.9	1,001.8	550.3	0.75	5.98	2.63	1.25

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO, INDEKSET E ÇMIMEVE DHE TREGU I PUNËS

GROSS DOMESTIC PRODUCT, PRICE INDEXES AND LABOR MARKET 2.

	Rritja reale vjetore e PBB me çmime konstante [6] (%)/ Annual real growth of GDP at constant prices [6] (%)	Me çmime korrente, në milionë lekë [7] / At current prices, in million ALL [7]				Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të konsumit (%) / Yearly changes in CPI (%)	Tregu i punës [8] / Labor market [8]	
		Produkti Brendshëm Bruto (PBB) / Gross domestic product (GDP)	Pagat e të punësuarve, neto / Compensation of employees, net	Të Ardhura nga prona, neto / Property income, net	Të Ardhurat Kombëtare Bruto / Gross National Income		Shkalla e punësimit / Employment rate (%)	Shkalla e papunësisë / Unemployment rate (%)
	1	2	3	4	5=2+3+4	6	7	8
2014	1.8	1,395,304.6	30,723.0	-17,930.9	1,408,096.8	0.7	50.5	17.9
2015	2.2	1,434,306.5	34,189.7	-17,189.6	1,451,306.6	2.0	52.9	17.5
2016	3.4	1,475,250.8	35,750.8	-11,837.0	1,499,164.7	2.2	55.9	15.6
2017						1.8	57.4	14.1

Burimi: INSTAT.

Source: INSTAT.

3. BILANCI I PAGESAVE [9], REZERVA DHE KURSI I KËMBIMIT

BALANCE OF PAYMENTS [9], RESERVES AND EXCHANGE RATE 3.

Në milionë euro, përveç rasteve kur shënohet ndryshe

In millions EUR, unless otherwise indicated

	Bilanci i llogarisë korrente / Current account	Nga të cilat: Bilanci tregtar / Of which:Trade balance (3-4)			Nga të cilat: Remitancat / Of which: Remittances	Investimet direkte neto / Direct investments, net	Rezervat valutore (stok)/ Reserves (stock)	Rezervat në muaj importe / Reserves in months of import	Kursi i këmbimit / Exchange rate Mesatare e periudhës / Period average	
			Eksporti / Export	Importi / Import					ALL / EUR	ALL / USD
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2014	-1,076.3	-2,215.6	931.7	3,147.3	591.9	-811.5	2,191.7	5.6	140.0	105.5
2015	-883.6	-2,298.9	771.1	3,070.1	597.1	-818.4	2,880.0	7.6	139.7	126.0
2016	-811.7	-2,602.8	713.7	3,316.5	614.5	-936.5	2,945.0	7.2	137.4	124.1
2017*	-866.0	-2,824.2	797.1	3,621.2	635.7	-993.8	2,995.9	6.7	134.2	119.1

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Source: Bank of Albania.

4. BILANCI FISKAL, STOKU I BORXHIT TË BRENDSHËM DHE BORXHI I JASHTËM

FISCAL BALANCE, DOMESTIC DEBT STOCK AND EXTERNAL DEBT 4.

Në miliardë lekë

In billions ALL

	Të Ardhura / Revenue		Shpenzime / Expenditure		Deficiti / Deficit			Stoku i borxhit të Qeverisë Qëndrore / Central government debt stock	
		Nga të cilat: Të ardhura tatimore /Of which: Tax revenue		Shpenzime kapitale / Capital expenditure		Financim i brendshëm / Domestic financing	Financim i huaj / Foreign financing	Stoku i borxhit të brendshëm / Domestic debt stock	Stoku i borxhit të jashtëm / External debt stock
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2014	366.7	335.9	438.8	60.7	-72.1	42.2	29.9	564.7	412.4
2015	379.2	342.3	437.4	63.1	-58.2	-6.4	64.6	551.4	490.9
2016	407.0	369.9	433.7	59.5	-26.7	9.2	17.5	561.1	504.6
2017	430.4	398.6	461.4	68.5	-31.0	1.9	29.1	577.1	510.3

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, sipas publikimeve "Statistikat fiskale mujore, viti 2018" dhe Buletini statistikor i borxhit, Shtator 30, 2018.
Publikimi 'Statistika fiskale Janar - Gusht 2018' tabelat:
Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (Vjetor).
Shënime:
1) Përditësuar të dhënat për Dhjetor 2015 sipas ESA 2010.
2) Përfshihen vetëm llogaritë dhe depozitat që janë pjesë e parasë së gjerë.
3) Përfaqëson kredinë për ekonominë.
4) Norma mesatare e ponderuar vjetore e depozitave dhe huave të reja 12 mujore në lekë për sistemin bankar.
5) Të dhënat i referohen normës në fund të periudhës.
6) Burimi: INSTAT faqja web dt. 09.01.2019: Temat / Ekonomi dhe Financë / Llogaritë Kombëtare (GDP) / Llogaritë Kombëtare Vjetore / Prodhimi i brendshëm bruto sipas metodës së prodhimit, 2010-2016 (2016 Gjysëm finale)
7) Burimi: INSTAT faqja web dt. 09.01.2019: Temat / Ekonomi dhe Financë / Llogaritë Kombëtare (GDP) / Llogaritë Kombëtare Vjetore / Kalimi nga PBB në të ardhurat kombëtare bruto, 2010-2016 (2016 Gjysëm finale)
8) Burimi: INSTAT faqja web dt. 09.01.2019: Temat / Tregu i Punës dhe Arsimi / Punësimi dhe papunësia / Shkalla e punësimit 2017 (grupmosha 15-64 vjeç), Shkalla e papunësisë 2017 (grupmosha 15-64 vjeç)
9) Janë rishikuar të dhënat për vitin 2017.

Source: Ministry of Finance and Economy, according to "Fiscal statistics monthly, year 2018 and "Debt Statistical Bulletin September 30, 2018", publications.
Publication 'Fiscal statistics January - August 2018' table:
Consolidated general budget (Annual).
Footnote:
1) Revised the data of December 2015 according to ESA 2010.
2) Deposits included in broad money.
3) Credit to economy.
4) The annual weighted average rate of the 12 months new deposits and loans in ALL for the banking system.
5) End of period data.
6) Source: INSTAT web site dt. 09.01.2019: Themes / Economy and Finance / National Accounts (GDP) / Annual National Accounts, Gross domestic product by production approach, 2010-2016 (2016 Semi Final)
7) Source: INSTAT web site dt. 09.01.2019: Themes / Economy and Finance / National Accounts (GDP) / Annual National Accounts, Transition from GDP to gross national income, 2010-2016 (2016 Semi Final)
8) Source: INSTAT web site dt. 09.01.2019: Themes / Labor Market and Education / Employment and Unemployment / Employment rate 2017 (age group 15-64 years), Unemployment rate 2017 (age group 15-64 years).
9) Data are revised for the year 2017.

1 SEKTORI FINANCIAR
1-1 BILANCI SEKTORIAL I BANKËS SË SHQIPËRISË
Në milionë lekë, fund periudhe

FINANCIAL SECTOR 1
SECTORAL BALANCE SHEET OF BANK OF ALBANIA 1-1
In millions ALL, end of period

	Totali i mjeteve / Total assets (2+ 3+ 4+ 5+ 8+ 12+ 13+ 14)	Ari monetar dhe mbajtjet e SDR*/ Monetary gold and SDR holdings	Arka në valutë / Foreign currency	Depozita*/ Deposits*	Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet / Securities other than shares (6+7)			Huatë / Loans (9+10+11)				Derivatet financiare / Financial derivatives	Llogari të arkëtueshme / Receivable accounts	Mjete jofinanciare*/ Nonfinancial assets*
						Jorezidentë / Nonresidents	Qeveria Qëndrore / Central Government		Qeveria Qëndrore / Central Government	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
2015/12	516,357.9	30,578.8	84.9	93,147.1	323,679.0	270,453.6	53,225.5	14,641.1	_	12,987.1	1,654.0	27.7	32,741.6	21,457.8
2016/12	524,730.8	27,211.8	52.0	104,622.9	315,112.7	261,877.5	53,235.2	31,660.3	_	29,934.4	1,725.9	15.8	25,094.1	20,961.2
2017/12	532,927.0	25,725.3	24.3	161,617.3	259,537.8	206,818.9	52,718.8	41,591.0	_	39,871.3	1,719.8	11.7	23,844.9	20,574.7
2018/06	495,278.0	22,265.0	28.2	183,232.9	216,811.0	163,000.9	53,810.2	30,300.6	_	28,615.5	1,685.1	20.1	22,069.2	20,551.0
2018/07	504,421.7	21,866.7	28.0	173,663.1	226,020.3	171,079.2	54,941.1	40,684.6	_	39,007.1	1,677.4	14.4	21,597.8	20,546.9
2018/08	516,553.2	21,708.4	27.5	180,759.5	229,415.3	173,879.6	55,535.7	42,145.7	_	40,476.1	1,669.7	17.4	21,962.6	20,516.8
2018/09	534,166.0	20,180.3	26.3	189,531.9	234,176.2	178,703.2	55,473.0	48,034.5	_	46,372.7	1,661.8	55.0	21,656.2	20,505.7
2018/10	556,461.6	20,168.1	49.9	190,225.1	259,205.4	203,550.4	55,654.9	44,510.6	_	42,861.4	1,649.2	18.1	21,790.6	20,494.0
2018/11	545,816.9	19,904.4	78.4	185,108.6	262,636.3	207,705.6	54,930.8	35,661.1	_	33,957.8	1,703.3	20.2	21,893.0	20,514.8

	Detyrimet totale / Total liabilities (2+ 3+ 4+ 10+ 14+ 15+ 16)	Paraja në qarkullim / Currency in circulation	Depozita të përfshira në paranë e gjerë / Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë / Deposits excluded from broad money (5+ 6+ 7+ 8+ 9)						Huatë / Loans (11+ 12+ 13)				Llogari të pagueshme / Other accounts payable	Alokimi i SDR / SDR allocation	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit / Shares and other equity
					Jorezidentët / Nonresidents	Qeveria Qëndrore / Central Government	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors		Jorezidentët / Nonresidents	Qeveria Qëndrore / Central Government	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations			
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2015/12	516,357.9	239,218.1	1,787.9	201,585.6	31,826.2	26,340.8	142,966.8	87.4	364.4	1,809.6	1,809.6	_	_	461.3	8,104.4	63,391.1
2016/12	524,730.8	258,848.0	3,183.2	191,379.7	19,860.9	18,975.1	152,349.7	72.1	121.9	314.2	314.2	_	_	1,164.6	7,981.2	61,859.9
2017/12	532,927.0	274,711.8	3,899.2	200,513.9	19,350.9	34,384.3	146,632.1	66.7	79.9	115.6	115.6	_	_	463.8	7,340.5	45,882.2
2018/06	495,278.0	268,278.5	123.0	185,154.3	17,411.5	48,468.8	119,163.4	61.6	49.0	55.6	55.6	_	_	560.8	7,067.3	34,038.4
2018/07	504,421.7	273,999.2	57.8	189,821.5	17,409.9	55,301.2	116,999.2	62.1	49.0	36.9	36.9	_	_	453.6	7,008.8	33,044.0
2018/08	516,553.2	280,924.2	57.2	193,238.7	17,396.4	56,315.2	119,418.6	62.1	46.4	18.5	18.5	_	_	623.9	7,052.6	34,638.1
2018/09	534,166.0	279,553.5	57.4	211,928.1	17,396.3	61,017.9	133,418.9	62.5	32.6	18.6	18.6	_	_	881.0	7,093.7	34,633.7
2018/10	556,461.6	276,188.7	102.7	238,571.6	17,386.4	93,699.3	127,405.8	48.6	31.5	18.6	18.6	_	_	422.4	7,095.5	34,062.2
2018/11	545,816.9	279,251.2	83.0	225,572.7	17,390.5	83,370.0	124,732.3	48.9	31.0	18.5	18.5	_	_	500.1	7,070.2	33,321.1

Burimi: Banka e Shqipërisë
** Për periudhën Dhjetor 2015-Prill 2016 është bërë riklasifikim i arit jo monetar nga zëri "Depozita" në zërin "Mjete jo financiare".*

Source: Bank of Albania.
**The data of December 2015-April 2016 reflect a reclassification of non-monetary gold from "Deposits "to " Non-financial assets".*

1-2 PARAQITJA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË

Në milionë lekë, fund periudhe

MONETARY SURVEY OF BANK OF ALBANIA 1-2

In millions ALL, end of period

	Mjete valutore neto*/ Net foreign assets* (2-3)	Pretendime ndaj jorezidentëve/ Claims on nonresidents	Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve / Less: Liabilities to nonresidents	Mjetet e brendshme / Domestic assets (5+ 8+ 9+ 10+ 11+ 12) Pretendime neto ndaj	Qeverisë Qëndrore / Net claims on Central Government (6-7)	Pretendime ndaj Qeverisë Qëndrore / Claims on Central Government	Minus: Detyrime ndaj Qeverisë Qëndrore / Less:Liabilities to Central Government	Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese / Claims on other depository corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare / Claims on other financial corporations	Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike / Claims on public nonfinancial corporations	Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare / Claims on other nonfinancial corporations	Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë / Claims on other resident sectors
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
2015/12	363,088.0	405,079.5	41,991.5	63,394.2	48,752.0	75,143.9	26,391.9	12,987.1	_	_	_	1,655.1
2016/12	389,612.7	418,562.1	28,949.4	65,915.7	34,255.6	53,279.9	19,024.3	29,934.4	_	_	_	1,725.7
2017/12	390,687.6	417,605.4	26,917.8	59,998.0	18,406.7	52,839.5	34,432.8	39,871.3	_	_	_	1,720.0
2018/06	365,283.3	390,138.1	24,854.8	35,734.4	5,432.2	53,951.2	48,519.0	28,615.5	_	_	_	1,686.6
2018/07	363,211.6	387,881.7	24,670.1	40,336.8	-348.1	54,986.3	55,334.4	39,007.1	_	_	_	1,677.8
2018/08	373,189.1	397,982.2	24,793.1	41,386.2	-759.8	55,592.4	56,352.2	40,476.1	_	_	_	1,670.0
2018/09	384,705.4	409,777.3	25,071.9	42,517.8	-5,518.1	55,539.9	61,058.0	46,372.7	_	_	_	1,663.2
2018/10	410,789.8	435,455.5	24,665.7	6,464.8	-38,046.7	55,705.4	93,752.2	42,861.4	_	_	_	1,650.1
2018/11	409,593.5	434,348.7	24,755.2	7,243.5	-28,418.6	54,983.5	83,402.1	33,957.8	_	_	_	1,704.3

	Baza monetare / Monetary base (14+15+16)	Paraja në qarkullim / Currency in circulation	Detyrime ndaj korporatave të tjera depozituese / Liabilities to other depository corporations	Depozita të përfshira në paranë e gjerë / Deposits included in broad money	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë / Deposits excluded from broad money	Huatë / Loans	Llogari të pagueshme / Other accounts payable	Të tjera neto / Other items net	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit / Shares and other equity
	13	14	15	16	17	18	19	20	21
2015 / 12	383,972.8	239,218.1	142,966.8	1,787.9	451.8	_	34.2	-21,367.7	63,391.1
2016 / 12	414,380.9	258,848.0	152,349.7	3,183.2	194.0	_	47.2	-20,953.6	61,859.9
2017 / 12	425,243.1	274,711.8	146,632.1	3,899.2	146.6	_	96.8	-20,683.2	45,882.2
2018 / 06	387,564.9	268,278.5	119,163.3	123.0	110.6	_	39.8	-20,736.0	34,038.4
2018 / 07	391,056.2	273,999.2	116,999.2	57.8	111.1	_	55.6	-20,718.6	33,044.0
2018 / 08	400,399.9	280,924.2	119,418.6	57.2	108.5	_	110.6	-20,681.8	34,638.1
2018 / 09	413,029.8	279,553.5	133,418.9	57.4	95.0	_	126.9	-20,662.2	34,633.7
2018 / 10	403,697.1	276,188.7	127,405.8	102.7	80.1	_	53.8	-20,638.6	34,062.2
2018 / 11	404,066.5	279,251.2	124,732.3	83.0	80.0	_	69.1	-20,699.7	33,321.1

Burimi: Banka e Shqipërisë

** Për periudhën Dhjetor 2015-Prill 2016 është bërë riklasifikim i arit jo monetar nga zëri "Depozita" në zërin "Mjete jo financiare".*

Source: Bank of Albania.

** The data of December 2015-April 2016 reflect a reclassification of non-monetary gold from "Deposits "to " Non-financial assets".*

1-3.A BILANCI SEKTORIAL I BANKAVE PARADEPOZITUESE/ MJETET

Në milionë lekë, fund periudhe

SECTORAL BALANCE SHEET OF DEPOSIT MONEY BANKS/ ASSETS 1-3.A

In millions ALL, end of period

	Totali i mjeteve / Total assets (2+ 3+ 4+ 8+ 12+ 22+ 25+ 26+ 27)	Arka në lekë / National currency	Arka në valutë / Foreign currency	Depozita / Deposits (5+6+7)				Letra me vlerë të ndryshme nga aksionet / Securities others than shares (9+10+11)	Nga të cilat / of which:		
					Jorezidentët / Nonresidents	Banka Qëndrore / Central Bank	Bankat paradepozituese / Deposit money banks			Jorezidentët / Nonresidents	Qeveria Qëndrore/ Central Government	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations
	1	2	3	4	5	6	7	8		9	10	11
2015/12	1,365,627.6	8,610.0	10,650.1	301,970.9	147,563.2	144,219.2	10,188.5	378,356.7		64,927.3	313,429.5	_
2016/12	1,446,048.9	9,424.8	13,685.4	302,582.2	140,174.5	151,994.3	10,413.5	426,178.2		92,042.1	333,995.3	140.7
2017/12	1,462,990.6	9,441.1	12,715.8	328,020.9	171,799.1	146,853.3	9,368.5	416,707.4		74,240.4	342,467.1	_
2018/06	1,438,539.1	11,487.1	14,036.1	308,600.8	177,004.3	122,634.9	8,961.6	430,337.7		83,909.2	346,428.5	_
2018/07	1,451,393.4	10,512.0	18,630.4	315,909.5	185,651.4	122,926.2	7,331.9	434,496.8		83,172.1	351,324.7	_
2018/08	1,460,515.5	11,031.6	16,606.5	328,189.2	198,814.0	124,761.0	4,614.1	432,600.6		80,628.9	351,971.7	_
2018/09	1,476,639.0	10,757.9	14,014.3	345,860.3	197,805.5	140,159.7	7,895.0	440,950.4		81,185.8	359,732.6	31.9
2018/10	1,459,760.3	10,745.2	12,136.6	334,036.1	201,039.2	127,540.4	5,456.5	443,973.4		81,567.6	362,373.9	31.9
2018/11	1,458,231.3	11,743.8	11,748.0	337,603.9	203,567.4	128,399.0	5,637.5	437,788.0		77,252.0	360,504.4	31.6

	Huatë / Loans (13+ 14+ 15+ 16+ 17+ 18+ 19+ 20+ 21)	Jorezidentët / Nonresidents	Banka Qëndrore / Central Bank	Bankat paradepozituese / Deposit money banks	Korporata të tjera financiare / Other financial corporations	Qeveria Qëndrore / Central Government	Qeveria lokale / Local government	Korporata jofinanciare publike / Public nonfinancial corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors	Aksione dhe instrumente të tjerë të kapitalit / Shares and other equity (23+24)	Jorezidentët / Nonresidents	Rezidentë / Residents	Derivatet financiare / Financial derivatives	Llogari të Arkëtueshme / Other accounts receivable	Mjete jofinanciare / Nonfinancial assets
	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27
2015/12	613,283.4	68,177.5	_	3,700.1	9,537.7	1,099.5	887.7	27,500.5	346,210.1	156,170.4	7,223.3	6,529.9	693.4	_	8,114.2	37,418.9
2016/12	637,885.3	94,431.0	_	2,561.2	8,687.6	947.5	845.5	26,863.9	343,070.3	160,478.3	8,023.0	7,192.2	830.8	_	8,886.8	39,383.1
2017/12	631,258.4	84,104.3	_	2,770.3	7,944.7	2,129.2	787.7	34,901.3	329,377.0	169,244.0	7,970.0	7,093.4	876.7	85.0	11,643.0	45,149.0
2018/06	612,341.1	73,631.0	_	9,527.6	8,552.4	7,243.0	737.4	19,583.9	320,863.3	172,202.6	7,798.7	6,899.0	899.8	81.6	8,760.9	45,095.0
2018/07	606,700.2	66,151.5	_	8,845.7	9,073.1	7,238.9	726.2	19,801.8	321,618.4	173,244.6	11,017.7	7,019.9	3,997.8	81.2	9,067.4	44,978.3
2018/08	606,799.4	67,126.3	_	7,741.0	8,726.4	7,261.1	721.8	19,742.7	321,167.5	174,312.8	10,959.3	6,948.3	4,011.0	81.7	9,451.2	44,796.1
2018/09	600,724.8	60,878.2	_	5,996.8	9,169.1	7,268.4	716.2	19,615.7	322,399.3	174,681.1	10,895.0	6,883.5	4,011.5	81.9	8,644.4	44,710.0
2018/10	597,280.0	61,963.7	_	4,258.01	9,617.2	7,196.0	646.3	19,291.8	319,514.4	174,792.6	7,845.7	6,947.2	898.6	82.1	9,283.3	44,377.8
2018/11	597,616.3	61,129.4	_	3,220.6	9,921.9	7,182.9	691.4	20,121.8	320,317.4	175,030.8	8,004.1	7,103.3	900.8	0.8	9,244.4	44,482.1

Burimi: Banka e Shqipërisë

Source: Bank of Albania.

1-3.B BILANCI SEKTORIAL I BANKAVE PARADEPOZITUESE/ DETYRIMET

Në milionë lekë, fund periudhe

SECTORAL BALANCE SHEET OF DEPOSIT MONEY BANKS/ LIABILITIES 1-3.B

In millions ALL, end of period

	Detyrimet totale / Total liabilities (2+ 8+ 17+ 20+ 28+ 29+ 30)	Depozita të përfshira në paranë e gjerë / Deposits included in broad money (3+ 4+ 5+ 6+ 7)	Korporata të tjera financiare / Other financial corporations	Qeveria lokale / Local Governments	Korporata jofinanciare publike / Public nonfinancial corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors	Depozita të papërfshira në paranë e gjerë / Deposits not included in broad money (9+ 10+ 11+ 12+ 13+ 14+15 +16)	Jorezidentët / Nonresidents	Banka e Shqipërisë / Bank of Albania	Korporata të tjera depozituese / Other depository corporations	Qeveria Qëndrore / Central Government	Korporata të tjera financiare / Other financial corporations	Korporata jofinanciare publike / Public nonfinancial corporations	Korporata të tjera jofinanciare / Other nonfinancial corporations	Sektorë të tjerë rezidentë / Other resident sectors
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16
2015/12	1,365,627.6	980,027.7	12,861.5	1,713.2	14,537.7	113,245.2	837,670.1	112,215.7	16,693.7	1,892.8	11,914.9	6,749.8	1,136.9	285.7	7,853.9	65,688.1
2016/12	1,446,048.9	1,005,978.9	11,997.6	2,292.5	13,154.1	136,885.4	841,649.4	138,410.1	14,902.5	356.2	13,771.4	9,277.4	938.9	338.3	8,106.7	90,718.7
2017/12	1,462,990.6	991,609.0	15,044.3	1,499.4	12,992.0	142,526.8	819,546.5	164,697.4	15,772.9	1,062.2	13,009.9	8,255.4	1,722.5	318.4	7,396.3	117,159.8
